

BIBLIOTEKA
SHTETIT

85H-2
052




JONUZ DINI

8JH-32
652

JONUZ DINI

VARKA E NOES

komedi në katër akte



SHTÉPIA BOTUESE «NAIM FRASHÈRI»

Redaktor: Vehbi Skënderi

Kopertina nga: Safo Marko

Tirazhi 2.000 kopje Format 70x100/32 Sfash: 2204-65

**Shtyp. NISH. Shtypshkronjave «MIHAL DURI»
Stabilimenti «8 NËNTORI» — Tiranë, 1972**

VARKA E NOES

VETAT VEPRUES:

FILIP BANUSHI	— major xhandarmërie
GJONI	— i biri, ish oficer.
TEFA	— i biri.
FREDA	— e bija.
LAJDJA	— mikesha e Filipit.
NOTERI	— mik i tij.
OFICERI	—
TOMA	— murator
LIZA	— shërbëtore
NDOCI	— shërbëtor
TETARI I ROJËS	
ROJA	
PARTIZANI	

Ngjarja zhviliohet gjatë vitit 1944 në një qytet të veriut.

AKTI I PARË

Mëngjez. Lulishte para shtëpisë që duket pakëz në anë të djathjtë. Nën një tëndë dredhëzash, me kokë të mbështetur në një tavolinë xunkthash, e ka zënë gjumi Gjonin. Gérhet. Te këmbët ka një shishe boshe. Në fund duket një pjesë e derës së oborrit dhe kabinë e rojes. Xhandari vëren Gjonin, që lëviz dorën në ajër për të përzënë, si duket, një mizë. Papritmas, i bie vetes me pëllëmbë në qafë. Zgjohet i trembur. Roja qesh dhe futet në kabinë.

GJONI — Oh, kush më ra? Po të mos e dija se babai është i shtrirë në shtrat, do të bëja be se kjo ishte shuplaka e tij.

FREDA — (*vjen duke fshirë lotët*) Ç'ke që flet me vete?

GJONI — Vdiq?

FREDA — Zoti deshi të mos plotësohet dëshira jote.

GJONI — Oh, sa thellë e ka shpirtin ai!

FREDA — Doktori i bëri dy injeksione, që ja larguan të keqen, si dora e zotit.

GJONI — Ai më duket se genjen, sepse s'e ka zënë asnjë plumb. Ku e ka plagën, ku e ka plagën?

FREDA — Unë ja lava gjakun atë ditë që e sollien.

GJONI — Edhe ti genjen si ai. (*kap shishen*)
Bosh! Kush e piu, ë?

FREDA — Ti.

GJONI — (*vëren shishen*) Shoh të kuq buzësh në grykë.

FREDA — Unë jam vajzë.

GJONI — Kushedi sa herë të kam thënë, mos i vën buzët aty ku i vë të miat.

FREDA — U, si flet ky! Po të dëgjonte njeri, do të mendonte se edhe unë jam pijanece si ti. (*përvajshëm*) Ti je i keq, Gjon... Ndofta po të pija pak, do të më lehtësohej dhembja që kam për tatën.

GJONI — Shko e gjej një vend tjetër të qash.

FREDA — Unë qaj aty ku më qahet.

GJONI — (*çohet dhe e shtyn*) Hajt, mbushu!

FREDA — Mos më prek!

GJONI — Mirë, qaj, qafsh rrashët tënde! (*thërrret*) O Ndoc!

FREDA — Mos thirrë, budalla, tatën porsa e zuri gjumi.

GJONI — Përderisa nuk mund të çohet, nuk e kam frikë.

FREDA — O zot, çirret si i gmendur! Sst! Po del Noteri. Tata dërgoi ta thërrasin, pa u zbardhur mirë.

GJONI — A, domethënë nuk paskërka bërë testament, ë?

FREDA — (*me dhëlpëri*) Ose e ka bërë, por do t'i bëjë ndryshime... (*thekson fjalët me ngasje*) Se tata vetë më tha: «Bija ime, plumbat e komunistëve më bënë t'i njoh edhe më mirë fëmijët e mij.

GJONI — E ke gabim, motër, ose e ke marrë

vesh keq. Ai duhet të ketë thënë për Lajden. Të gjithë ne nuk peshojmë as sa një fije floku e kokës së nderuar të zonjës së nderuar Lajde (*qesh*).

ROJA — Ndal!

FREDA — Oh! Ata... (*mbështetet në krahët e Gjonit*)

GJONI — Diçka po ndodh...

TEFA — (*hyn duke dihatur*) Më trembe, o mustaqemi.

ROJA — Mos luaj! Tetari i rojes.

TEFA — Ej, hiqe grykën, se po zbrazet kot. Gjon, Fredë, luani bre, se ky si duke qeshur po më çon atje ku s'kthehem më.

GJONI — Është vëllai ynë.

FREDA — Tefa.

ROJA — Nuk e njoh. (*Nga e majta vjen tetari*).

TETARI — Ah, na falni zotni Tefë, është i ri e nuk ju njeh.

FREDA — I ri, megjithatë lesh nën hundë!

TETARI — I ri, domethënë, ka ardhur sot për të parën herë këtu, zonjushë. Ja, prandaj e quajmë të ri, kuptioni?

TEFA — I ri, i ri, po mua qe duke më tharë me tym baruti, o tetar.

TETARI — Jo, pritna zot, as mos e mendoni atë, sepse këtu ka rregull, kuptioni, zotërinj? Ka disiplinë. Çarkun e pushkës nuk e luan gishti i tij, por fjala ime, domethënë, urdhëri im. (*Rojes*) Është këshfu, more?

ROJA — Si urdhëron, ashtu është.

TETARI — Pastaj, që ta dini, zotërinj, edhe ju zonjushe, komanda, këtu, në shtëpinë e zotit qarko mandant i çon njerëzit më të besuar. E shikoni këtë

rojen? Është nga ata xhandarët të cilët edhe top t'i vësh para, nuk e ndalon dot. Mjafton t'ju them zotërinj edhe zonjushe — se trupi i tij është i shpuar nga pesë plumba komunistësh.

FREDA — Oh, i shkreti!

TETARI — Babai juaj i nderuar është me gradë më të lart se ky (*bën me dorë nga roja*) por me plumbë në trup ky ja kalon. Domethënë, më kuptioni julu tem, ky, Zyberi, se Zyber i thonë, është ushtari i babës suaj të nderuar, por unë e thashë këtë që ju ta merrni vesh, që ky e meriton të qëndrojë në oborrin e zotërinjve dhe tuajin, zonjushe.

GJONI — Mirë, e morëm vesh.

TETARI — Edhe unë gëzohem shumë. (*largohet duke biseduar me zë të ulët me rojen*)

GJONI — Na habiti ai kastravec. (*kap Tefën për krahu*) Hë, i takove?

TEFA — Më lerë të marr frymë. Oh, m'u vu prapa një gjato... Unë vrap, ai vrap. Uh, më ngriu gjaku. Thashë se po shkoja bedel për babën. I ngjas shumë, e marrtë e mira.

GJONI — (*me inat*) Ti ke lepurin në bark, more kungull, prandaj të duket hija jote njeri! He! Na i zure veshët! I ngjas babës, i ngjas babës. Ti i ngjet babës, ashtu si miza buallit.

TEFA — Mirë, mirë, edhe sikur të mos i ngjas, si thua ti, po a jam i biri? A nuk mjafton kjo, që komunistët të më fshijnë nga faqja e dheut?

GJONI — Lëri përrallat! Folë për punën. Ti, Freda, ç'rri aty e përgjon?

FREDA — Rri ku më pëlqen.

GJONI — (*kap Tefën për krahu*) Largohe mi.

TEFA — Ja dhashë letrën Zefit. Kur e lexoi, qeshi.

GJONI — Qeshi!

TEFA — Po deshe, thuaj zgërdhini dhëmbët.

GJONI — Nuk ka rëndësi.

TEFA — Ka që ç'ke me të, se nga gazi i tij mora vesh që nuk do të na japë asnje kacidhe. «Jepi të falat e mia zotit Gjoni!» tha e më përçolli. Shkova te Deda. Ky foli ndryshe, po fundi, aty doli. I treti i vërteti, thashë dhe vravova te Zyber agai. Ky nuk qeshi kur lexoi letrën, veç u suall një copë herë me të në dorë. Dikur hapi gojën: «Po të kisha një dokument të zotni major Filipit, që të më vlente si garanci, do ta hapja kuletën me tridhjetë përqind kamatë, se më vjen keq për ju...»

GJONI — Qeni!

TEFA — «Fjala, besa, betimi nuk vlejnë asnje grosh sot tha.

GJONI — E ç'dokument?

TEFA — Kini durim sa të vdesë zotni Filipi, më këshilloi.

GJONI — Prit gomar të mbijë bar!

TEFA — Shkova në agjensi të vaporëve.

GJONI — Të thashë për aeroplan.

TEFA — Nuk mund të udhëtoj me të, se jo vëtëm më merren mendtë, por mos harro bajamet...

GJONI — Bëj petulla në ujë, vëlla. Unë të thashë, pasi t'i futish paret në grusht, shko e blej biletat.

TEFA — Nuk humba asgjë.

GJONI — O zot, o dreq, na shpëtoni nga kjo skëterrë!

TEFA — Mendo diçka Gjon! Ty të pjell mendja shumë.

GJONI — (*sillet mendueshëm, befas*) Duhet ta futim në dorë firmën e babës.

TEFA — Eh, një fjalë goje, po qysh?

GJONI — Shko e gjej një letër të bardhë. (*sheh Fredën që i vëren*). Dëgjo ti, asnë fjalë për ikjen tonë, more vesh?

FREDA — (*vështron dhe hesht*).

TEFA — Ajo, për të fituar përkrahjen e babës, na i qet krenat në pazar kur të duesh.

GJONI — Po unë ja qit sytë më përpara.

FREDA — Më marrshi të keqen. (*futet në shtëpi*).

GJONI — O Ndoc.

TEFA — Përsëri po pi?

GJONI — Vera është këshilltarja më e mirë: sa hyn ajo në barkun tim, truri nis të prodhojë mendime interesante. O Ndoc!

Duket Ndoci

NDOCI — Me thirrët, zotëri.

GJONI — Na, merre shishen e mbushe.

NDOCI — Me ujë?

GJONI — Lëri llafet!

NDOCI — Nuk i kam çelësat e kantinës.

GJONI — I ke, i ke.

NDOCI — Í kisha, por kur i erdhi goja zotnisë së madh, më thirri lart dhe m'i mori. «Ti i jep Gjonit të pijë!» tha. I bëra be. Ma preu: «Hesht ti! Pse, me ujë dehet ai?»

GJONI — Një ditë edhe ujët do të na ndalojë, kini për të parë.

NDOCI — Edhe ti zotëri e ke tepruar pak.

TEFA — Pak? (*qesh*) Shumë. E ka kthyer shtëpinë në mejhane.

GJONI — Heh, kush po flet!

TEFA — Pas buke e pi ndonjë gotë verë edhe unë... por... (*del. Pas tij bën të dalë edhe Ndoci*).

GJONI — Prit ti. Po sikur tē mē gënjes?

NDOCI — Pér këtë kryq, nuk kam çelësa.

GJONI — Më jep pesë franga.

NDOCI — Oh! Ç'u bëra unë, Banka di Napoli?

M'i ke pesë franga, zotëri, e nuk e vret mendjen pér tē m'i kthyer.

GJONI — Kur tē hy në punë.

NDOCI — Ti në punë ishe mjaft mirë, oficer si baba, por pija...

GJONI — Oficer! Më mirë qen se oficer sot. Të ishe atje në Mallakastër kur na rrethuan partizanët...

NDOCI — Prandaj ja mbathe, zotëri?

GJONI — More, më vinte plasje që nuk vrapoja më shumë.

NDOCI — Baba deshi tē vriste veten nga turpi.

GJONI — Nuk është nga ata burra ai.

NDOCI — Më fal, zotni, por këto fjalë nuk më pëlqejnë.

GJONI — E ke frikë.

NDOCI — Eh, more zotni, ti nuk e di sa zor është tē ushqesh gojë, tē veshësh shtatë njerëz e tē mbathësh katërmëbhjetë këmbë. Po tē mos kisha pesë fëmijët e gruan samar mbi shpinë, ehe, nuk do tē kishte djalë nëne që tē më dilte para.

GJONI — Prit.

NDOCI — Nuk i kam mjelë ende lopët, zotni.

GJONI — Merre shishen.

NDOCI — Ta mbush me qumësht (*niset*)

GJONI — Lëri shakatë, dëgjon? (*i vihet prapa. Dalin*).

Freda duket te shkallët e shtëpisë. Murmurit një

melodi të trishtueshme. Nga e kundërtat vjen Toma. Ka ndër duar një mistri dhe një kovë.

FREDA — He, mendjemadh, as të përshëndesësh, nuk e merr mundimin.

TOMA — Mirëmëngjezi, zonjushe.

FREDA — Prit, Tomë.

TOMA — Kam punë. (*lë kovën dhe mistrinë në një vend, ku duket se muri është prishur pak.*)

FREDA — Gjithnjë ikën!

TOMA — Po të më shohë zoti major, duke bërë muhabet, më piu e zeza.

FREDA — Ai nuk është i zoti të lozë prej shtrati.

TOMA — Nuk është mirë që je kaq e shkujdesur, kur yt atë lufton me vdekjen.

FREDA — Shiko sa sentimental ky! Ai e ka kullotur livadhin.

TOMA — Edhe ti nuk je aq e uritur... (*shkon nga kopshti*).

FREDA — (*me inat*) Harbut! (*ulet në një karrike*)

Nga shtëpia del Noteri dhe pas tij Tefa.

TEFA — Nuk po më tregoni gjë, zotni noter?

NOTERI — Nuk më lejon profesioni, i dashur zotëri.

TEFA — Rregulli ka edhe përjashtime.

NOTERI — Çdo përjashtim ka një çmim... (*qesh me dhelëpëri*) Békérka edhe rimë.

TEFA — Rimë nuk ka.

NOTERI — Mirë, rimë nuk ka, po merret vesh?

TEFA — Merret. Por, të betohem, se po të më vrasësh tani, nuk më gjen asnjë lek në xhep. Baba thotë: për të ngrënë kini, për të pirë kini, të veshur jeni. Për të bërë qejf, fitoje vetë, thotë. Po ku? Si?

Me çfarë, ë? Kjo kohë është kaq e turbullt... Natë fare, do të thoshja. Besomëni, zotni Noter, dal shumë rrallë, se i ngjas shumë babës më marrtë e mira, e komunistët aq duan, që të m'i japid edhe mua një tre plumba si plakut. Është mëkat, apo jo, zot i mirë, të shkoj tani, në lule të rinisë.

NOTERI — Më falni, zotni i dashur, por duhet të shkoj.

TEFA — Vetëm kaq më tregoni: tokat a m'i ka lënë mua? Atje në fshat do të isha i qetë. Edhe këtyre bajameve të bekuara do t'u bënte mirë ajo klimë. (*mbështjell qafën me shall*) vuaj shumë prej tyre, zotni noter. Hë, më thuaj diçka, të keqen.

NOTERI — Ju thashë...

TEFA — Një peshqesh mund t'ju bëj.

NOTERI — Për shembull?

TEFA — Për shembull... një gjeldeti. Jua sjell në mbrëmje, se nuk dua të më shohë njeri. Jua zgjedh të majmë, përfjalë të nderit.

NOTERI — E keni zot, zotëri. Një gjeldeti ka vlerën e një presjeje, po t'ju jap të shkruar atë që dëshironi të dini.

TEFA — Ah! E mora vesh, «...që dëshironi të dini». Ju shkau gjuha zotni Gaspër, ju shkau gjuha padashur... (*qesh i kënaqur*)

FREDA — (*e kap përmëngë noterin*) Hë çfarë i dëftuat Tefës, zotni Gasper?

NOTERI — Asgjë, bija ime.

FREDA — Asgjë? Po atij i ndrit fytyra nga gëzimi.

NOTERI — Nuk mund ta ndaloj që të gëzohet kur i teket. Dësheron të shohë ëndrra me sy çelur, e dashur, e po mirë, le të shohë, mua nuk më dëmtton gjë.

FREDA — Dëgjo, zotni Gaspër, ose më falni pak... Po të doni, edhe mund të qaj, për t'ju bindur se vuaj. Më thoni, ju lutem, më thoni: asaj shtrigës, Lajdes, i ka lënë gjë?

NOTERI — Nuk di, vajzë e dashur, nuk di as-gjë, më vjen keq. Ditën e mirë!

FREDA — U, po shkoni pa më kallëzuar diçka... «Nuk di»... Unë nuk jam foshnjë që të mos e marr me mend sa dini.

NOTERI — (*qesh*) Dituria nuk jepet falas.

FREDA — Këtu është fjala të di atë që do ta marr vesh nesër.

NOTERI — Fare mirë, zonjushe e dashur, pritni deri nesër.

FREDA — Të pres gjer nesër!...

TEFA — Mua më nxehë dhe më ftohe brenda një minute, zotni.

NOTERI — Bajamet e kanë fajin. (*Dëgjohet Gjoni që kendon, pas pak duket me një shishe në dorë*).

GJONI — Evviva la torre di Pisa, ke pende, ke pende e mai viene giu! Oh, oh, oh, kë po shoh! Salute, noteri im, salute! (*afrohet dhe e puth*). Ja, një njeri që më bëri për vete e unë s'e pashë. Ju, zotni Gasper, keni hiret e një femre të bukur. (*qesh*) Po, po, po! Çoje një herë. (*i jep shishen*). Për shëndetin tim.

NOTERI — (*vëren grykën e shishes*) Verë pa çelur mirë sytë!

GJONI — Vera është gëzim.

NOTERI — Kur ke edhe mish të majmë përpara, po.

GJONI — Mos bëj naze!

NOTERI — Nuk...

FREDA — S'është mirë kështu, Gjon.

GJONI — Çoje! Të bëftë mirë. Tani ulu aty.

Këtë shishe do ta pimë bashkë. (*Tefës dhe Fredës*)
Ej, ju të dy, mos na zini diellin.

TEFA — Kemi pjesën tonë.

FREDA — Njeri kaba.

NOTERI — Zoti Gjon, i dashur, më vjen keq
që nxitohem e nuk mund t'jua plotësoj dëshirën.

GJONI — Pi shpejt e shko.

NOTERI — Ju falemnderit për bujarinë, por du-
het ta dini, se ndërsa juve jeni me lugë në brez, unë
ende s'e kam fituar bukën thatë.

GJONI — Më mallëngjeve (*qesh*)

NOTERI — Për Krisht.

TEFA — (*noterit*) Shkoni, shkoni. Ma futet dy-
shimin në zemër, ju marrtë e mira.

NOTERI — Dyshimi e besimi është si hija e pe-
ma, zotëri i dashur: më parë sheh hijen, pastaj pe-
mën, ose pemën pastaj hijen.

GJONI — Lëri pemët e hijet, por çaje!

NOTERI — Nuk dua.

GJONI — Tregomë ç'ndryshime bëri plaku.

NOTERI — Ku?

GJONI — Në testament.

NOTERI — Që ta dini, zoti Filipi, babai juaj,
nuk ka bërë fare testament.

TEFA — Ah!

FREDA — Çudi!

GJONI — Lëri rrenat.

NOTERI — Mbajeni gojën!

GJONI — Hape çantën.

NOTERI — «Hape çantën»! Kusar jeni ju?

GJONI — Hape të thonë e mos më shtyj të ta
thyej shishen për kokë.

NOTERI — Mos bëni shaka, zotni i dashur.

GJONI — E kam me gjithë mend. Hape!

NOTERI — Ndihmë! (*Tefa e mban Gjonin*)

TEFA — Zotni Gaspër, mos u trembni. Jam unë këtu.

FREDA — Edhe unë. (*edhe Freda e mban vëllanë*)

TEFA — Kështu e ka ky, vret e pret me fjalë, po asnje nuk ka vdekur deri tani nga dora e tij.

NOTERI — Ah, zotni gojëmbël, nuk dua që unë të jem i pari. Vetëm këtë kokë kam e nuk dua t'i bëj as edhe një gërvishje sado të vockël.

GJONI — Lëshomëni! (*e shtyn Tafën e lirohet*)
Ik, moj ti.

NOTERI — Mbathja se s'është vonë. (*Niset*)

GJONI — Ndal! (*i matet me shishe*) Ssst! Asnjë fjälë.

NOTERI — Mëshirë!

GJONI — Çantën.

NOTERI — Jo.

GJONI — Hape vetë.

NOTERI — Kurrë.

GJONI — Tefë, sillma sépatën. Dua ta çaj më dysh si trungun.

NOTERI — Çantën nuk e lëshoj para se të mbyll sytë. Zoti Tefë, zonjushe, të dashur, mos rrini duarlidhur, po ndërhyni, bre!

GJONI — Përpara!

NOTERI — Ku po më çoni?

GJONI — Në burg. Roje!

NOTERI — Nuk keni të drejtë.

GJONI — Roje, çoje, në burg.

ROJA — Tetari i rojes!

TEFA — Lëre të shkojë.

FREDA — Nuk bën të tallesh deri në këtë pikë, vlla. Zoti Gasper është mik i babës dhe person me rëndësi.

GJONI — O çantën, o shpirtin.

NOTERI — Asnjérën.

TETARI — (*vjen me vrap*) Ç'është? Oh, pse i mbani duart përpjetë, zotni?

NOTERI — Nuk e shihni shishen?

TETARI — Nuk është revole, domethënë.

NOTERI — Mos i qit dhëmbët jashtë, po hiqja nga duart.

TETARI — Zoti Gjon, bën shaka.

GJONI — Shaka, shaka. Çoje, tetar.

TETARI — Si urdhëron, domethënë. Gëzuar!

(pi)

NOTERI — Ika. (*fshihet pas Tafës*) Më përcill.

TEFA — Më prit në shtëpi nga ora tetë.

NOTERI — Të dal shëndosh, se çdo gjë rregullohet. (del)

FREDA — (*Tafës*) Pse i fërkon duart?

TEFA — Dëgjo, motër, dëgjo shpirt, unë nuk jam vlla i keq... Kam zemër ari unë.

FREDA — Folë!


TEFA — Ssst! Po të bjerë pasuria në dorën e tij, hëm!, rrush e kumbulla do ta bëjë. E njoh mirë atë, megjithëse i kemi dhënë besën njeri-tjetrit që...

FREDA — Që? Çfarë?

TEFA — A, mos më ngut, nuk mund ta kaloj kufirin e qësë... Bile, edhe deri aty eca desi pa mend.

FREDA — Mirë, mirë, lëre, po ç'të tha ai noteri.

TEFA — Ai më tha... Eh, po na shikon ai, Gjoni.



2256

19334

FREDA — Largo hemi.

TEFA — Jo, se më keq është. Bëj buzën në gaz. Ashtu. Largo hui pak. Jo, më mirë mos buzëqesh. Vrejtu. Hë, mirë. Qëndro ashtu (*kollet*) E pat: zëri m'u trash. U ftoha, noter. Ah, bajame, bajame! (*prek fytin*)

FREDA — Nxirre të shkretën.

GJONI — Hë, more ju, ç'po komplotoni kokë më kokë? Tefë, afroju këtu.

TETARI — Urdhëroni uluni.

GJONI — Mos i the gjë asaj për planin tonë?

TEFA — Gojëkyçur si peshku.

Nga porta hyn oficeri me një dosje nën sqetull. Tetari brof në këmbë e nderon dhe merr drejtqëndrim.

TETARI — Zoti toger, çdo gjë në rregull, domethënë me përjashtim të një loje të vogël që bëri zoti Gjoni, këtu prezent, me një zotëri që iku me tetar Arif Zogun.

TOGERI — Mirë, mirë. Njatjetani, zotërinj. Mirëdita zonjushe.

FREDA — O, mirë dita, togeri ynë.

TETARI — Më jepni leje të shkoj, zoti toger.

TOGERI — Shkon. (Fredës) Zoti major si është sot?

FREDA — O zot! Jeta e tij varet nga fija e perit.

TOGERI — Atëhere unë paskam ardhur gabim.

GJONI — Uluni, uluni të pimë. Mos e prishni gjakun, zotëri, babai im nuk do t'ju lejë të pritni shumë.

TOGERI — (*ulet mëdyzash*) Derisa zonjushja thotë...

GJONI — Zonjushja i zmadhon gjërat. Çoje!
TOGERI — Gëzuar!

Filip Babuna duket te shkallët. Pas tij Liza. Të gjithë mbeten të habitur nga kjo e papritur.

FILIPI — U myka atje në dhomë.

FREDA — O, sa gëzohem që të shoh në këmbë, babi!

FILIPI — Bija e babit. (e rrok)

TEFA — Mbështetu tek unë babë.

FREDA — Jo, jo, tek unë.

GJONI — Më i sigurt jam unë.

FILIPI — Jam i rëndë, jam i rëndë bijtë e mi.
(Oficerit) Ec këtu. (Ai afrohet. Mbështetet në të) Pse ke ardhur?

TOGERI — Për një shkresë, zoti major. (Ecin ngadalë)

FILIPI — Një?

TOGERI — Shkresë.

FILIPI — Lizë, të thashë, mos e lerë zonjën Lajde vetëm.

LIZA — Ajo vetë më tha, të të shoqëroj mos...

FILIPI — (i kënaqur) Ashtuuu! (ulet) Oh! Ah, këto plagët, këto plagët ma morën shpirtin... (Liza i vë jastëkun të pëshitet) Ik tashti lart! (Liza largohet.) He, more ti, pse ke ardhur?

TOGERI — Për një...

FILIPI — ...shkresë. Po. Djalë i mirë. (Apo djalë i keq duhet të të them?) po e tëpron, e besa po ta kuq një ditë, që të të djegë tërë jetën, merr vesh?

TOGERI — Më falni, por...

FILIPI — Pusho! Njëmijë herë të kam thënë, shkresat t'i sjellësh në orën dyimbëdhjetë për firmë, e jo një, po të gjitha.

TOGERI — Si urdhëron, po puna është se...
(i pëshpërit diçka në vesh) prandaj... (Duket Toma me një shkallë në krah).

FILIPI — A, ndryshon puna (e merr, e hap shkresën, e lexon pastaj e nënshkruan) Më jep vu-lën.

TOGERI — E vulos unë, zoti major.

FILIPI — Jo, unë (merr vulën, e vë mbi shkresë). O, plaga, plaga e marrtë dreqi, më ther në shpirt.

GJONI — (me qëllim) Mirë që është një, ba-ba.

FILIPI — Një? Tri, more dembel, tri. E kam trupin shoshë... por nuk më lë zemra të rri rënë, megjithëse edhe zemra e shkreta s'ka faj se është lodhur shumë, punon keq, bijtë e mi: nganjëherë vrapon thuese e ndjek dreqi prapa; e them me vete: «Bukur, po ikë e po më le...» Vulën po e ndal kë-tu.

TOGERI — Nuk është nevojë, jua sjell çdo ditë, si gjithnjë.

FILIPI — Jo. Kam menduar gjatë mbrëmë... Vula e firma shkojnë së bashku, si krahu e dora. Pa fjalë! Kur të vdes unë, ndryshon puna: merrni edhe kokën, po deshët, e luani futboll. Pse qan, marro-qe?

FREDA — Ohy, ti, tatë, e përmend vdekjen si-kur të jetë dasmë.

FILIPI — Lëri lotët tani e dëgjo ç'them unë. Çudi e madhe, kujtoni se lotët ma mbushin mendjen më tepër se fjalët. Mjaft! Freda, bijë, pusho, fshiji lotët. Ashtu. E shikoni vulën? E shikoni edhe toge-rin? E? Ky bukuroshi këtu me këtë vulë mund të bëhet pasanik brenda një ore, me këtë vulë. Në këtë

kohë, kjo rrumbullake bën çudira... Kështu. (*Officerit*) He, ç'kemi ndonjë të re?

TOGERI — Mbrëmë vranë nëntoger Hajdarin me kapter Ndrecën.

FILIPI — Ah! (*kap zemrën me dorë*) Ta merr mendja: tufën pa çoban e ha ujku. Ai zëvendësi im është kokëtul. Pse nuk e hetoi më parë?

TOGERI — Kjo ndodhi si me rastin e plagosjes suaj, zoti major.

FILIPI — Pusho! Nuk të lejoj ta zësh në gojë plagosjen time, ndër sy të fëmijëve të mi, merr vesh?

TOGERI — Më falni, zoti major.

FILIPI — Më falni, por deri kur të të fal? Çudi e madhe. Një ditë po të largohem unë, qyteti bëhet çorbë, e, o burra komunistë, nxirri lugët e hani sa të mundeni. Po gjermanët pyesin për mua? (*sheh Tomën dhe Ndocijn*) Ju kputni qafën! (*Ata largohen*) Folë!

TOGERI — Frici më tha se zoti major është shqiponjë.

FILIPI — Kush është ky Frici?

FREDA — Ai togeri me monokël, tatë, ai bukuroshi, që erdhi së bashku me kolonelin Brunger për t'ju parë pas plagosjes.

FILIPI — Rri ti. Pyes këtë këtu.

TOGERI — Është adjutant i kolonelit.

FILIPI — Ah, po, djalë i urtë ai, po i bukur nuk m'u duk: flokëverdhë, i shplarë. Nuk di pse e lodh veten duke e shtrënguar me vetull atë copë xham.

TEFA — Është baron.

FILIPI — E di, mos më shit mend; po pikërisht

pse është ba'on, pse t'i japi atë sëkëlldisje vetes. Çudi e madne. Hë, more ti, a i internuat ata?

TOGERI — Jo! Zëvëndësi i zotërisë suaj, kapiteni Arif Topi, thotë se duhen shqyrtuar edhe një herë listat, se ka njerëz të pafajshëm.

FILIPI — Po, si urdhëron, nuk është plagosur ai, po unë, prandaj e merr me nge ai. Listat i kam parë unë. Ja the ti këtë?

TOGERI — Ja thashë.

FILIPI — (*shkruan diçka*) Dorëzoja këtë. Po nuk e zbatoi urdhërin tim të dytë, më njofto.

TOGERI — Si urdhëron.

FILIPI — Po ata të tre që dogjën depon?

TOGERI — Do të dalin në gjyq.

FILIPI — Ku ka gjyq, more tutkun: pushkatum. Pse, me gjyq na vrasin ne komunistët rrugëve, hë? — Ty të pyes.

TOGERI — Thonë se duhet vërtetuar fajësia e tyre. Ju e dini, zoti major, edhe pse i torturuam shumë, nuk pranuan asnjë akuzë.

FILIPI — Pritni se po pranojnë! Hëm. Ende nuk u bindët, se komunistëve, më parë u nxjerr dhëmbët se fjalët. Çudi e madhe!

TOGERI — Kapiten Arifi thotë se ata nuk janë as hija e komunistëve.

FILIPI — Mjaft, e mora vesh. Keni ngrënë diçka...

TOGERI — Më vraftë zoti, unë asnjë grosh...

FILIPI — Pusho! E keni bërë pazar qarkoman-dën. He, po ju zura me presh në dorë, ju var, ta dini. Ik tani mos të ta shoh surratin. Çudi e madhe. Ti e Arifi shani njëri-tjetrin ditën e vidhni bashkë natën, si punë e asaj përrallës. Ik! (*Vjen Liza dhe*

largohet.) Hë, moj ti, pse e lë vetëm zonjën tënde, ë?

LIZA — Zonja Lajde më tha të blej... (*i dëftët në vesh*)

FILIPI — (*i kënaqur*) Mirë, mirë, bëj si thotë zonja. (*Liza del.*) Hë, ti more, ç'rri si hu aty?

TOGERI — Më jepni leje të largohem, zoti major.

FILIPI — Unë thashë ik, çudi e madhe! — Ah, ç'je një mjeshtër lajkash ti! Po nuk më hyn në zemër, jo. Dua punë unë e jo fjalë. (*Oficeri del.*) Këta oficerët tonë (*shikon Gjonin*), janë të zotët për t'u krehur dhe pispillosur më mirë se gratë e nuk vleinë pesë pare si burra. M'i ka mustaqet si bisht miu ai. Hëm! Kur isha në moshën e tij, i kisha deri te veshi.

FREDA — A të të mbuloj pak, babi.

FILIPI — Unë po shkrihem nga djersa!

FREDA — Pikërisht, të mos ftoshesh.

FILIPI — (*Tomës*) Kreve punë në jerevinë e bagëtive?

TOMA — Po. Tani po ndreq murin. (*tregon vendin*)

FILIPI — Mirë. Pastaj, hyrë në pullaz e zerë dy vrima. Ti, Ndoc, afrohu, tregoji Tomës ku na pikon çatia.

NDOCI — Si urdhëron.

FILIPI — Edhe dëgjo: po i dhe verë këtij plepit këtu... Tfu edhe emrin e kam bezdi t'ia zë në gojë, po i dhe verë, të var atje në kopsht. E sheh atë manin? Atje do të të përkundet trupi, ta dish.

NDOCI — Që kur më dhatë udhëzimet e fundit zotëri, nuk i jap edhe sikur të përmbytet bota

FILIPI — Mbrëmë më thanë se qe bërë prap tapë.

NDOCI — Me verën tonë, jo...

FILIPI — A, çudi e madhe! Pse, mos doli jash-të për të pirë ky? Hëm! Nuk ja mban atij ta kapër-cejë prakun e derës. Ka frikë se e vrasin komunistët zotëri. Kurse unë (*rreh gjoksin*) E ti thua nuk ka pirë. E shoh në sy se ka pirë unë. (*Gjonit*) Ec këtu ti, afrohu, afrohu. Aty. Hukat. Jo, jo aq lart, se nuk nuhas me kokë unë, por me hundë. Ule gojën. Hukat. Hehe! I del grahma e verës, si të ishte damixha-ni. Ik, pijanes!

TEFA — Unë, babë, edhe në vend të ujit po ta vësh, se shtie në gojë, sepse nuk do ti...

FILIPI — Hesht, hesht, se një mall jeni.

FREDA — Mos e bëni nervoz babën. Të keni dhembje për të... Në vend që të gëzoheni që e shih-ni këtu, në mes tonë, ju i prishni gjakun.

FILIPI — (*Ndocit e Tomës*) Ikni ju, ikni. Ti, Ndoc, do ta paguash gjithë verën që ka pirë ky.

NDOCI — Unë me dorë time nuk i kam dhënë gjë...

FILIPI — Oh, tani po del diçka tjetër, çudi e madhe! E vodhi? Po qysh? Ka falsifikuar çelësat? Atëhere puna ngatërrrohet më shumë! (*Gjoni do të flasë*) Pusho, ti! Nuk të jap leje të flasësh. Si the, si the? Më mbushe mendjen. Pse aq budalla jam unë, sa të të zë besë ty, Ndoc djali!

FREDA — Babi!

FILIPI — Rri ti!

NDOCI — Mund ta ketë blerë jashtë, zotëri.

FILIPI — Me gurët e lumit?

NDOCI — Jo, por me pare.

FILIPI — Atëhere del pyetja: ku i mori? E shi-

kon, e shikon se puna ngatërrohet edhe më shumë? Dalim prapë te vjedhja. Por unë nuk të zë besë, për atë që thashë, sepse, për të më vjedhur paret, duhet çelësi. Ik kput qafën!

NDOCI — Si urdhëron (*del*) Edhe ju shkoni. (*Gjoni e Tafa. shkojnë në shtëpi.*) Ti, Tomë, ec pak.

FREDA — Ta pjek një kafe, baba?

FILIPI — Jo, thuaji Lajdes të më bëjë një limonadë të freskët.

FREDA — Ta bëj vetë, babi.

FILIPI — (*disi i nxehur*) Çudi e madhe, unë them ajo duhet ta bëjë.

FREDA — Mirë, mirë, babi, mos e prish gjakun, të keqen. (*e rrrok*)

FILIPI — O, mjaft se kam vapë (*e largon*. *Ajo buzëqesh në drejtim të Tomës e largohet.*) Ai ndoci, o Tomë, ma ka prurë te maja e hundës, po çka t'i bëj, ë? Duhet t'i them derrit dajë. Ku ta gjej tjetrin? Fut në shtëpi ndonjë gjarpër, ndonjë komunist, që më vret natën në gjumë.

Vijnë Gjoni dhe Tefa duke u zënë

TEFA — Jo, nuk e ka firmën ashtu.

GJONI — Kështu si them unë e ka. F e madhe, pikë, e mbiemrin me një gremçë që zgjatet e bie poshtë si bisht mace.

TEFA — Oh, ma mbushe mendjen! Ai e shkruan emrin e plotë e mbiemrin, jo me grremç, por me një rrumbullak nën të.

GJONI — Me grremç.

TEFA — Me rreth!

GJONI — Vëmë bast?

TEFA — Toke.

FILIPI — He more, ç'ju kérceu në kokë? Shko, Tomë, e puno, se ne kemi kohë për përralla. (*Toma largoheret.*) Hë, flisni. Të dy afrohen në një kohë. Te-fa nxjerr një letër të bardhë dhe ja vë përpara, në tryezë.

TEFA — Të lutem, babë, vëre një firmë këtu e ta shohë ky në kam të drejtë unë, apo ai.

GJONI — Ta shohësh ti, se unë e kam parë.

TEFA — Vëre, babë, vëre.

FILIPI — (*shikon herë njërin herë tjetrin, hulumtues dhe pastaj befas e bën shuk letrën dhe e flak, qesh*) Lo jë e bukur, nuk ke ç'i thua, por ka një të keqe, bijtë e mi: nuk jam unë ai budallai që e ha këtë kokérr ulliri.

GJONI — Ku e sheh ullirin këtu?

FILIPI — He, more bukuroshë, unë di fjetur sa dini ju çuar.

TEFA — As firmën nuk duhet ta shohim?

FILIPI — Firmën? Eh, asgjë besa! Po ta kishit firmën time në dorë, do ta kishit gjithë qyettin. Ikn! Kputni qafën.

GJONI — Ti kudo sheh kurthe baba...

FILIPI — Sepse kurthe kam ngrehur tërë jetën. Çudi e madhe. Ju kam thënë, kputni qafën! (*Gjoni me Tafën largohen të dëshpëruar. Vëren në hesh-tje, për pak, Tomën që punon.*) Ka duar ai, djalë i mirë. Edhe baba yt, i ndjeri, ka qenë kështu, i hesh-tur, i butë, i përvujtur, i bindur. Kishte lindur për të qenë shërbëtor. Po, po, nuk i mungonte asgjë për të qenë i tillë. Mbaj mend, isha i ri atëhere, e nuk di si m'u dha, ndërsa ai punonte, ja, kështu si ti, ju hodha në shpinë. Ai i ngrati u rrëzua e ndoshta u vra, kudi unë, po he nuk e hapi gojën të më shan-te ose të ankohej. Ti i ke ngjarë krejt atij: fjalëpak,

i butë, punëtor i zellshëm. Kështu i dua njerëzit unë. Po t'i thotë zotëria: hidhu prej ure në lumë, plumb poshtë, nuk ka fjalë të tjera. Ah, q'po më sillet kjo mizë e mallkuar (*e gjuan*). Heeee, të zura, të zura! Tani dënimin; se unë nuk të fal, po të zura, ta dish (*e mbyt*). Edhe fëmijët e mi janë si kjo mizë, parazitë: hanë në trupin tim. Po ai roja ku është, ka fjetur thua? Tetari i rojes!

TETARI — (*nga jashtë*) Urdhëro! (*hyn me vrap*) Urdhëro!

FILIPI — Ç'urdhëro, more të falsha dreqit! Fjetur ishe?

TETARI — Si urdhëron, jo. Domethënë, porsa isha bërë gati të merrja një sy gjumë, se mbrëmë, si e dini, zoti major, domethënë, mbrëmë isha këtu, në këmbë, se natën, si e dini, natën e kaloj çuar sepse nata, si thoni edhe vetë, zoti major, nata është e pabesë, e kështu, unë, ushtari juaj besnik, sytë na, se jo vetëm kam përgjegjësi për jetën tuaj, por edhe ju dua. Po guxoj t'ju them, ju dua, zoti major, megjithëse ju, domethënë, nuk kujtoheni për mua ushtarë tuaj besnik. Pse, do të thoni? Po ja, zoti major, ka tre muaj që i ka kaluar koha shiritit të dytë. Për fjalë të nderit, domethënë, edhe sikur të mbës tërë jetën kështu me këtë vizë, nuk ankohem, sepse kam kënaqësi të madhe t'ju shërbëj ju, e vettëm juve, sepse jeni trim dhe i mençëm. Kaq patë.

FILIPI — Shumë pate, çudi e madhe. Ti qenke llafazan i madh. Ku dreqin të ka gjetur ai kapiten Arifi? Ik, shiko rojen, se duket edhe ai ja ka marrë me gjumë, se dita, more kastravec, nuk qenka e rrezikshme, ë? Pse, nuk qe ditë kur më plagosën mua?

TETARI — Si urdhëron, ditë ishte, po ju beto-

hem, zoti major, mua nga pikëllimi, domethënë, m'u veshën sytë me diçka, që m'u duk jo vetëm natë, ju betohem, por natë pa yje, pa hënë, sterrë. Kësh-
tu, kështu, se ju jeni për ne... e në mënyrë të ve-
çantë për mua, babë. Po, babë. Bile këtë ua thashë
edhe fëmijëve tuaj. Po ta lë kokën për ju, eh, atë-
here domethënë, vdes i kënaqur, edhe po të mos i
kem shiritat çift.

FILIPI — O Krisht, sa i pafytyrë qenke! Dëgjo,
mos më dil më në sy. Ik tani e shiko rojen.

TETARI — Nuk do t'ju dal si urdhëroni, sep-
se jam i bindur, domethënë, se ju, zoti major, sa he-
rë të shihni një rreshter, do t'ju shkojë mendja te
shiriti im, te ushtari juaj besnik...

FILIPI — (bërtet) Mjaft! Çudi e madhe! Mos
i ka dhënë Ndoci edhe këtij verë? Ec këtu. Hukat!
Po. Qelbesh erë verë. Ku e more? Trego.

TETARI — Ju betohem, domethënë, po, kur
rruhem, i hedh fytyrës alkool, sepse thonë i bën mi-
rë, thonë ku ta di unë i shkreti, po meqë thonë, e
bëj gjithnjë këtë.

FILIPI — Oh, kastravec faroç! Ke harruar se je
me mjekër. Ke pasqyrë?

TETARI — Nuk ankokemi, zoti major, në shtë-
pi të zotërisë suaj i kemi gjithë të mirat. Ja, bëni
hesap vetë, unë, edhe pse më ka dhembur dhëmba-
lla...

FILIPI — O, ç'njeri i poshtër! Thyej qafën!

TETARI — Si urdhëroni, po e thyej, po e thyej,
sepse zbatoj urdhërin tuaj, që për mua, ushtarin tuaj
besnik, është urdhëri i zotit, domethënë, urdhëri i atij
që na ka në dorë jetën e vdekjen tonë. Amen!

FILIPI — (e gjuan me papuçë) Maskarai.

TETARI — (kap papuçen dhe e puth) E puth, po,

po, e puth domethënë, se është këmba juaj që më bie, këmba juaj e nderuar, sepse unë, ç'ka jam fundja, unë jam ushtari juaj besnik, jam tapeti juaj, ku këmba juaj e nderuar mund të shklasë kur t'i teket. Kaq. Ika!

FILIPI — Qërohu!

TETARI — Si urdhëron, qërohem. (*nderon dhe largohet, nga kabina e rojes. Aty diçka kërkon. Filipi mbështetet për tavolinë e ul kokën mbi krahë, nuk lëviz. Tetari e ngre rojen dhe e nxjerr jashtë*) Hë, flije ti, domethënë flije kur unë, tetari yt, komandanti yt haja shqelmet e zotit major për ty qen, murtajë e keqe! Flije! hë!

ROJA — Jo, por atëhere po më sillej gjumi ndër sy...

TETARI — Ku je ti këtu, në pazar, apo në krye të detyrës? Në front, more, në front, se kjo shtëpi, kupton domethënë, kupton se kjo shtëpi prej çasti në çast mund të sulmohet e ti, hajvan, kërric, apo, më mirë, gomar, mushk, flë, e bashkë me ty flë edhe pushka, kjo pushkë që ta kemi dhënë për t'i ruajtur ata atje. Ssst! Mos bërtit, se ai atje, komandanti ynë mezi është çuar nga shtrati për të na parë ne, për të na falënderuar për guximin e besnikérinë tonë, e ti flë.

Vjen Freda me tabaka në dorë, ku duket gota e limonadës

FREDA — Pije, babi.

FILIPI — Pije vetë.

FREDA — Unë e solla për ty.

FILIPI — Mos më shurdho veshët. (*çohet*) Më ndihmo të ngjitem lart. Këtu kam frikë të fle. Lark

Lajdes, e kam rrezikun gjithnjë afër. Ti nuk je e zonja të më mbash. Vetëm gojën e ke të fortë, bija ime. Hej, more ti, Tomë, ec këtu, më ndihmo të ngjitem shkallëve.

TOMA — (*do t'i kundërshtojë një herë, por... afrohet*) Mbështetu.

FILIPI — Po të ishte gjallë yt atë, do të më çonte në shpinë lart. Ka qenë div ai; mend ka pasur pak, po fuqi si kafshë. (*Futen në shtëpi. Edhe Freda u shkon pas.*)

Vjen Liza nga jashtë. Edhe Toma del nga shtëpia.

TOMA — Tani e kisha mendjen tek ti, Lizë.

LIZA — Unë tërë ditën tek ti e kam...

TOMA — Dua të të them diçka.

LIZA — Unë atë pres përditë.

TOMA — Shkojmë atje, që të jem afër vendit të punës e të mos i biem në sy kujt.

LIZA — (*e ndjek*) Gjë e gëzueshme?

TOMA — Si ta marrësh, Lizë.

LIZA — Ti e di, Tomë, unë... ty...

TOMA — Një herë tjetër, nuk është koha tani për ato fjalë. Do të më ndihmosh?

LIZA — (*ngre supet*) Kur s'e di për çka. (*buzëqesh*)

TOMA — Kur pashë vulën, Lizë, më lindi një mendim. Tre shokë do të pushkatohen së shpejti.

LIZA — Oh, të mjerët ata!

TOMA — Duhen shpëtuar.

LIZA — «Duhen shpëtuar», thua se e kam vëtë në dorë atë punë.

TOMA — E ke; heto ku e ka fshehur vulën ai derri.

LIZA — Do tē përpinqem.

TOMA — Megjithatë, unë do tē pyes shokët, por jam i bindur se vula i shpëton ata shokët. Po, sidoqoftë, vula mund tē na hyjë në punë, prandaj e dua prej teje.

LIZA — Si t'ja bëj unë e gjora?

TOMA — Kur tē flejë... (*Vjen Freda, Toma e shikon me inat.*) Bisedojmë më vonë. (*nis punën*)

FREDA — (ironike) Po derdhkeni sheqer.

LIZA — Që ta lëpish ti, zonjushe. (*ikën e zemëruar për ndërprerjen e bisedës*)

FREDA — Uh, fundërrinë! (*Tomës*) Vërtet ke gjë me tē?

TOMA — Ajo është vajzë e mirë.

FREDA — Unë e keqe jam?

TOMA — Nuk thashë gjë.

FREDA — Pikërisht, e marr me mend atë që fsheh. Po unë jam më e mirë se ajo, bile shumë më e mirë, që ta dish. Së paku edukatë e kulturë kam aq sa t'u shes edhe të tjerëve.

TOMA — Nuk t'i blen kush, zonjushe, se janë mall i vjetër... (*merr veglat dhe largohet nga kopshiti*)

FREDA — Më marrshi ethet e verës! (*kthehet nga ka ardhur, ndeshet me Gjonin, e Tafën, që dalin nga shtëpia me ngutje*)

TEFA — Ishte e mrekullueshme!

GJONI — (*vëren nga shtëpia, poshtë*) Qenka në sallon. Thirre!

TEFA — E kam inat.

GJONI — Harroje inatin tanë. Thirre!

TEFA — Mirë. (*afrohet pak*) Zonja Lajde, ju lutemi, merreni mundimin dhe dilni pak këtu. Kemi dy fjalë unë dhe Gjoni. Vetëm dy... Ju lute mi.

Vjen *Lajdja*: (*është grua e bëshme*)

LAJDJA — (*buzagaz*) Hë, more, pëllumba, ç'hallkeni?

TEFA — Ti e di se ne të duam...

LAJDJA — (*mbledh supet*) Ku ta di unë e mjerë?

GJONI — Ne kemi respekt të madh për ju, se jeni grua me vyrtyte të larta.

TEFA — Dhe me zemër të artë.

LAJDJA — Lërini lajkat, ç'doni nga unë?

GJONI — Ne jemi të rinj.

TEFA — I riu ka nevoja të shumta.

GJONI — Babës nuk i vete mendja se ne u bëmë për martesë.

TEFA — Prandaj të lutemi ty...

GJONI — Ty që të shihet në fytyrë mirësia...

TEFA — Ty që të buron prej sysh mëshira.

LAJDJA — Mjaft, se m'i morët mendtë. Bini shkurt.

TEFA — Thuaja, Gjon. (*nxjerr një letër të bardhë*)

GJONI — (*tregon letrën*) Shkruaja babës dhe kërkoi një shumë të hollash për ne. Kur të mos jesh ti këtu. ja dorëzojmë. Ai ty të jep edhe shpirtin...

TEFA — Neve as gur për të çarë kokën s'na jep.

GJONI — Do t'i kthejmë një ditë : betohemi!

TEFA — Betohemi!

GJONI — Ne do të largohemi; do të shkojmë pér të fituar vetë kafshatën.

TEFA — Edhe pér ju do të jetë e leverdisshme: do të keni këtu vetëm Fredën. Shkruaje, ta marrsha.

GJONI — Ju lutem, shkruajeni (*i jep stilografin që ka nxjerrë nga xhepi*)

LAJDJA — Unë nuk e tradhëtoj Lipin tim.

TEFA (*bie në gjunjë*) Zonja Lajde, na shpëto!

LAJDJA — Budalla, çohu se ndyve pantallonat.

GJONI — (*i kap dorën me një gjest kalorsjak*) E puth këtë dorë të bardhë, të butë e fisnike, që lidhet me një zemër të bardhë, të butë e fisnike.

TEFA — Ti ke në dorë jetën dhe vdekjen tonë.

GJONI — Jepnani njérën.

TEFA — Jetë, jetën, jetën!

LAJDJA — Nuk di q'të them...

GJONI — Ju dëftojmë ne, zonjë (*i shtrin stilografin*) Shkruani.

TEFA — «Lipi im i dashur. Më dërgo me letër prurësin 1000 napolona» Kaq.

GJONI — Në fund: «Lajdja jote e ëmbël.»

TEFA — Mjafton të shohë shkrimin tënd, se e hap kuletën menjëherë.

GJONI — Nuk të kushton gjë. Ai është baba ynë, e, në fund të fundit, ne marrim paret tonë.

LAJDJA — (*papritmas*) Ünë jam grua besnike, morët vesh? e nuk ja ngul thikën pas shpine Lipit tim pér hatër tuaj.

TEFA — Thikën? Nuk shoh kund thikë.

GJONI — E keni gabim, zonjë.

LAJDJA — E keni gabim ju.

GJONI — (*që po e humb durimin*) Shkruaje!

LAJDJA — Nuk dua.

TEFA — Mos e bëj të përdor forcën, zonja Lajde.

LAJDJA — Oh, më frikësuat! (*qesh*).

GJONI — Shkruaje! (*nxjerr paksa dorezën e një thike buke*)

LAJDJA — (*e sheh; klith*) Ndihmë, ndihmë!

GJONI — (*e fsheh thikën*) Bëra shaka, zonjë, qetësohuni. (*Duket xhandari.*)

Edhe Filipi del në dritare

FILIPI — (*i tronditür*) Ç'pate, shpirt?

LAJDJA — (*tregon me gisht Gjonin*) Ky mah-lukati deshi të më mbytte.

FILIPI — Roje! (*Lajdja futet në shtëpi*).

ROJA — Urdhëro.

FILIPI — Kape!

ROJA — (*i drejton pushkën*) Mos luaj!

FILIPI — Vëri prangat katilit.

Xhandari i vë prangat, Gjoni nuk kundërshton dhe mbetet i hutuar nga kjo e papritur, që nuk e kishte parashikuar. Befas dëgjohen krisma pushkësh e bombash. Klithma grash në shtëpi. Filipi fshihet. Vjen tetari duke rendur, me revolver në dorë.

TETARI — Roje! Këtu e ke vendin, makalush, te dera domethënë. (*Filipi qet kryet për të parë*) Atje! (*e shtyn*) Të vdesësh, more vesh, si ushtar besnik i... (*sheh Filipin*) Zoti major, futeni kokën brenda, atë kokë të vyer, për të cilën ne këtu, domethënë vdesim... sepse unë, që ta dini ju, zoti major, jam ushtari juaj besnik. (*Trokitje të forta*) Roje! Asnjë njeri të mos kalojë prakun. (*Trokitje edhe më të forta*) Baaarkas! (*Bie roja, bie edhe ai vetë*) Zjarr!

NOTERI — (*nga jashtë*) O, më vratë, he u vraf-të zoti!

TETARI — Atë duam: të vrasim. Armë mbush! Gatiii!

FILIPI — Ndaluni, more kastraveca, hapeni derën. Ai është zotni Gaspri.

TETARI — Urdhëroni ta hapim, e hapim. Roje, hape! (*Dera hapet. Hyn noteri.*)

FILIPI — Hë, ç'ndodhi?

NOTERI — Më lerë të marr veten njëherë. (*Ulet nё njё karrike. Befas çohet dhe pёrqafon rojen, pastaj tetari.n.*) Ju lumtë që nuk dini të qëlloni, ju lumtë se ndryshe unë kisha flutuar.

TETARI — Më falni, po lavdërimet nuk na takojnë neve, domethënë, por atij atje, zotit major qarkomandantit tonë trim e të mençëm, që nuk ka shok. E shikoni zotëri?

FILIPI — He, zoti Gasper, ç'ndodhi atje?

NOTERI — E pat edhe kapiten Arifi. E pashë kur u rrëzua. E pata shumë afër.

FILIPI — Zëvendësi im?

NOTERI — Dora vetë, zotëri me nja dy a tre të tjerë.

FILIPI — Oh, zemra... (*bie. Klithmë grash*).

Perdja

AKTI I DYTE

Sallon i vogël në katin përdhesë; hyrja me xhamillëk. Kundruall duken shkallët që të çojnë lart. Të varura në mure, në një vend të dukshëm mbi një sixhade: një shpatë, një hutë, një kobure, ngjitas pikatura e gjyshit Loro Babuna, mbartësi i armëve. Përbri shkallëve pianoja. Ballas dy dyer: njëra e kuzhinës dhe tjetra e një depoje të vogël.

Mëngjez herët.

Toma është brenda dhe kqyr lart. Duket i shqetësuar. Kur dëgjon zhurmë këmbësh, fshihet pas pianos.

Nga shkallët zbresin Liza dhe Ndoci.

NDOCI — Mbaje mirë, dëgjove?

LIZA — Eh, si je edhe ti: kjo nuk ka krahë.

NDOCI — Ta shoh edhe një herë.

LIZA — Ec tani.

NDOCI — Ta shoh edhe një herë.

LIZA — Ec tani.

NDOCI — Ta shoh, ta shoh.

LIZA — Kalama! (*ja tregon*) Ja.

NDOCI — Hëëë! Ti na nxore kaq telashe!

LIZA — Duhet t'ja falim, Ndoc, derisa i shpëton ata tre shokët.

NDOCI — Ja fala.

NDOCI — Del Toma

TOMA — Më bëni muhabet, sikur të jeni në shtëpi tuaj!

LIZA — Shpejt sa nuk i ka dalë gjumi. (*ja jep vulën Tomës*) Oh, ç'hoqa! U futa në dhomë, Tomë, e pashë se atë gotën me sifon e me atë barin që më dhe ti, e kishte pirë. (*Toma luan kryet dhe nxjerr një letër*)

NDOCI — Gérhiste si derri në thark. (*Toma vë vulën mbi letër*)

LIZA — I hoqa zinxhirin nga qafa lehtë-lehtë, po zemra më hidhej përpjetë, oh, sikur donte të më dilte nga gjoksi.

NDOCI — Unë rrija gati me këtë. (*tregon një copë dërrasë në formë kopani*) Po të lëvizte, pomb kokës. O vulën, o shpirtin!

TOMA — Ju lumtë! Ky gjëz i vogël, ju futi në luftë me gjithë mend. Tokeni! Edhe një herë ju lumtë! Tani çoje lart, Lizë. (*ja jep vulën, tund letrën i kënaqur*) Kjo shkresë e hap derën e burgut.

NDOCI — Po qysh?

LIZA — Derisa e hap, ç'të duhet më tepër. Ika. (*u ngjitet shkallëve lehtë*)

NDOCI — Atë pyetjen time po e lë për nesër.

TOMA — Mos kérko që të gjitha pyetjet të kenë përgjigje:

NDOCI — Nuk më beson?

TOMA — Edhe tani gabove Ndoc, e po më detyron edhe mua të bëj një gabim që të bind se të besoj me kokë. Që ta dish, sonte, disa shokë, të veshur si xhandarë, do të shkojnë në burg me këtë urdhër te major Filip Babunës, do t'i marrin tre të

burgosurit, gjoja pér t'i çuar në qarkomandë..

NDOCI — E mora vesh. Mendje e hollë. Jeni guximtarë.

TOMA — Mirupafshim.

NDOCI — Ta ndifsha tē mirën. (*e rrok*) Dreeeq, Gjoni! E paskan liruar nga burgu lugatin!

TOMA — Nuk dua tē më shohë.

NDOCI — Dalim këtej. (*i prin nga dera e kuzhinës. Dalin.*)

Hyn Gjoni. Është shumë i dëshpëruar.

GJONI — Edhe kjo ndodhi: pa pasur mendi min më tē vogël tē vrisja njeri, më plasën në burg. Sa e zymtë m'u bëjeta! (*ja ngul sytë kobures, e merr dhe e vështron*) Gryka jote do t'i jepte paqe këtij shpirti tē trazuar. E ç'kuptim ka tē rrash në këtë skëterrë, ku plaku, gardiani mizor, ta gris jetën fije-fije, si griset një copë jetër? Sa tē më shohë, do tē më hidhet: «Të liruan, të liruan, qen!» (*i hedh sytë pikturës*). Eh, gjysh, gjysh, sa pjellë tē keqe ke lënë prapa! Thonë se ke qenë burrë i mirë, po nuk më besohet: ajo fytyrë thotë tē kundërtën. Përderisa ke qenë babai i këtij ujk, duhet tē kesh qenë ujk edhe t'i vetë. (*befas diçka i kujtohet, ofshan*) Ah, Itali, Itali, o jetë studenteske, që nuk kthehesh më! (*kqyr koburen*) Koburja, ja kufiri i këtij udhëtimi. Ku tē gjej barut edhe saçma? Sigurisht çiftja e plakut do tē jetë lart. (*e var koburen ku ishte*) Më prit! (*niset. Nga shkallët ulet Liza.*) O zonjushë, mirëmëngjezi!

LIZA — (*disi e trembur*) Mirëmëngjezi, zotëri.

GJONI — Po tē vendosja tē martohesha, ty do tē tē merrja grua.

LIZA — Të lutem, më lësho rrugë.

GJONI — Ti je e bukur.

LIZA — Kam punë, zotëri.

GJONI — Zotëri? Qen thuaj. (*i afrohet*)

LIZA — (*e largon*) Mos u bëj i keq.

GJONI — Kush është i mirë në këtë shtëpi, që të mos të bëhem i keq? Ti je e mirë, Liza, prandaj unë i keqi, unë qeni... do të marr pak mirësi nga buzët e tua. (*do ta puthë*)

LIZA — (*e shtyn*) U çmende?

Duket Ndoci me kopanin, që kishte pak përparrë.

GJONI — O Krisht, si nuk kuption që kjo është çmendenë e jo shtëpi!

LIZA — Do të thérres.

GJONI — Njeriut, që është velur ngajeta, nuk e ka frikë as zotin as dreqin.

(*Ndoci afrohet dhe çon kopanin për t'i rënë, po në atë kohë Liza tregohet më e shpejtë: i bie me shputëtë*)

LIZA — I poshtër! (*ikën në kuzhinë. Gjoni i vihet mbrapa*)

NDOCI — (*i del përparrë*) Zotëri, po gëzohem shumë që po të shoh.

GJONI — Mua as ndër mend nuk më ka rënë përt ty.

NDOCI — E di. Po përvë?

GJONI — Më ka lodhur malli shumë.

NDOCI — E sheh? Heeee, zotëri, unë t'i di pikat ty... Po të sjell nga ajo e Kallmetit, veç kujdes plakun se na var të dyve, apo, jo, mua vetëm, atje te mani, ma ka caktuar vendin.

GJONI — Pse kaq bujar sot?

NDOCI — Nuk i përngjet dita ditës, zotëri. Pse, nuk është gëzim i madh që u ktheve shëndosh e mirë?

GJONI — (*i sheh kopanin*) Ç'e ke atë?

NDOCI — Këtë... e përdor për të përzier bërsitë.

GJONI — Shitja tjetërkujt atë rrënë; e ke për t'i rënë ndokujt kokës.

NDOCI — Edhe atë punë e bën.

GJONI — Mos deshe t'i dilje zot Lizës?

NDOCI — Edhe ajo mund të ndodhë, meqë e kisha në dorë.

GJONI — Ashtu?

NDOCI — Si urdhëron, ashtu.

GJONI — (rrëptë) Brenda një minute dua verën këtu.

NDOCI — Peqe.

GJONI — Edhe dëgjon: do të të provoj sa trim je.

NDOCI — Trimëria, zotëri, është si puna e zjarrit, sa më shumë dru t'i hedhësh, aq më i madh bëhet.

GJONI — E ç'janë ato dru?

NDOCI — Kur i vjen njeriut shpirti te hunda...

GJONI — Mua më ka dalë krejt... (*Ndoci del. Ulen Freda dhe Tafa. Kur e shohin Gjonin mbeten të ngrirë. Ju vjen keq që më shihni, ë?*)

FREDA — O vlla, ç'është ajo fjalë! (e përqafon) U tronditëm nga kjo e... papritur.

TEFA — (i jep dorën) Mirë bënë që të liruan.

GJONI — Edhe mirë edhe keq si ta marrësh.

TEFA — Atje nuk ka verë, kurse këtu ka.

FREDA — U, shyqyr që u kthyë në mes tonë.

TEFA — Te babai po shkon?

GJONI — Çiftja atje është?

TEFA — (e kap) Çfarë do të bësh? Mos u ngut. Unë kam një parandjenjë: çdo gjë do të rregullohet

si duam ne. (*Vjen Ndoci me shishe; ja jep Gjonit tinëz dhe del*) Ja unë sot jam qefull: bajamet i kam mire. (*bën ca vokalice*). Edhe zérin bilbil.

GJONI — Na hëngre shpirtin me ato bajamet e tua. Djalli i marrtë ato dhe atë që i mban në fyt. (*qesh e pi*)

FREDA — Po pate ndonjë hall, fol vlla: ke motrën. (*e vëren në bebëza të syve*.) Dukesh shumë i pikelluar.

GJONI — I mbaruar nuk thua? Ai barkderri atje lart po na bën të vdesim para tij. (*pi*)

TEFA — Njeriu vdes kur t'i mbushen ditët. Nuk mund të shkosh atje, pse i është mbushur mendja kësaj, Fredës, ose mua, ose fundi edhe ty, se atëhere do të bëhej një çorbë. Zoti ka vënë rregull. Vetëm ai thotë: Vdis, e ti duhet të vdesësh.

GJONI — (*përçmues*) I mençur je. Kur thotë zoti, vdis. Posi, posi. Po të them unë vdis, me një plumb kokës, hidhesh me këmbë përpjetë pa pritur urdhërin: «Vdis»!

TEFA — Edhe atëhere zbatohet vendimi i Zottit.

GJONI — Ik, mos më çaj kokën me përralla.

TEFA — E di ç'shoh në ty, vlla?

GJONI — Me syze a pa syze?

TEFA — Ujkun shoh, atë ujkun që deshi të han-te dynjanë, po nuk kishte dhëmbë (*qesh*)

FREDA — Nuk ke dhëmbë, o ujk fatkeq (*qesh e shkon te pianoja*).

GJONI — Ruajuni prej ujkut, edhe pse nuk ka dhëmbë (*i përshëndet me një gjest kalorsiak*) Nderimet e mia! (*nis të ngjitë shkallët*).

TEFA — Prit! (*i del përpara, e tërheq, nën zë*) U hutuam pas llafeve dhe ne harruam kryesoren. (*nxjerr*)

nga xhepi një zarf. Freda luan diçka në piano) Durim. (nxjerr një letér nga zarfi). Kjo letér éshtë një ide e shkëlqyer e kétij këtu. (rreh gjoksin me mburrje.) Do të na i mbushë grushtet me pare. Dëgjo.

« Zoti major Filip Babuna

Këtu

Deri në orën 12 të natës, të datës 8 të këtij muaji, t'i lini në fund të kopshtit, afër shegës, në të djathëtë të qymezit të pulave, 2000 napolona ar.

Në qoftë se shuma e lartpërmendur nuk do të ndodhet aty, në vendin e caktuar, në orën e caktuar, ju nuk do ta shihni dritën e diellit më datën 9.

Komunistët»

GJONI — Nuk pi ujë. (*çon shishen*)

TEFA — U, pse?

GJONI — Ai do diçka të fortë, që ta tronditë thellë e ta detyrojë për të hapur kuletën. (*ngjitet lart*).

TEFA — (*mbetet i stepur nga fjalët e Gjonit*) Lobje e fortë... Hëm! Pse e butë të duket ty kjo, more mendjehollë? Do të shohësh, do të shohësh. (*thërrët Ndoc, o Ndoc more!* (*Mbyll zarfin*))

NDOCI — (*vjen nga kuzhina*) Ç'ke zotéri?

TEFA — (*i shtrin zarfin*) Jepja babës.

NDOCI — Pse nuk ja jep vetë?

TEFA — Ashtu éshtë puna.

NDOCI — Tani jam i zënë.

TEFA — Ani, më vonë, veç mos i thuaj kush ta dha.

NDOCI — Postieri po i them.

TEFA — Jo, nuk ka pulla. Një i panjohur, thua-
ji.

NDOCI — Mirë.

TEFA — Ky shërbim i vogël do të të sjellë
shpërblim të madh.

NDOCI — Me fjalë?

TEFA — Me besë.

NDOCI — Eh, more zotëri, po të bëheshin pare
premtimet e babës tënd, unë sot do të isha pasaniku
më i madh i qytetit.

TEFA — Unë nuk jam baba.

NDOCI — Një gëershërë ju ka prerë (del)

TEFA — (sillet nëpër sallon mendueshëm, me
duar të lidhura prapa.) Keq... keq... keq... (Del nga
kuzhina Liza me tabaka me pjata) Ku shkon?

LIZA — Po ia çoj zotërisë së madh mëngjezin.

TEFA — Afrohu. Hë, a ka tepruar kotoletë
mbrëmë?

LIZA — Mbrëmë kishim rosto.

TEFA — A! Paska qenë parmbërëmë.

LIZA — Këtë javë s'e kemi parë me sy, zotë-
ri.

TEFA — E shikon, Lizë, kujtesa... nga mungesa
e vitaminave dobësohet e shkreta. Fruta duhen ngrë-
në, fruta. Rrushin e vreshtit nuk e pamë me sy: e
shiti. Nejse. Rosto a ka tepruar?

LIZA — Pak.

TEFA — Mbrëmë s'u ngopa: isha i sëmurë. Ti e
pe... (prek fytin)

LIZA — E, megjithatë, racionin e përlatë.

TEFA — E ç'është ai racion, zonjushe, ç'është?
Baba thatë: Racion lufte, siurdhëron, po barku im i
gjorë nuk di ç'është lufta. Është shëndoshur moj Li-
zë, do të bluajë ai. Hekur po t'i fut, nuk bën fjalë,

e bluan. Me pak mundim, dihet, por e bluan. Roston po ma jep?

LIZA — Duhet t'i marr leje zotërisë së madh.

TEFA — Lëre, e marrtë e mira, lëre. Ai një javë... C'them. Një muaj rrjesht do të ma përmendë: «E shikon Tefën? Tërë ditën rrin e ha sa pér tre vëtë.» Ai të numron kafshatën, moj Lizë. Lajdja po e ha pér së gjalli, po e kullufit me gjithë kocka, e ai meket nga kënaqësia.

LIZA — U lodha, zotëri. (*tregon tabakanë*)

TEFA — Më fal, më fal. (*Liza shkon lart, ndërsa ky i afrohet Fredës.*) Motër, na merr diçka të gëzueshme. Oh pse po qan, budallaqe?

FREDA — Duhet të qaj, Tefë: u vyshka.

TEFA — Edhe unë, po nuk jam i marrë të derdh lotët, pse vyshkem më shpejt, ashtu.

Hyn noteri.

NOTERI — Mirëmëngjezi, bijtë e mi të dashur.

TEFA — Ta solla gjeldetin, po ti s'më prite në shtëpi.

NOTERI — Një punë shumë e ngutshme më detyroi të dilja jashtë. Babai lart është?

TEFA — Po.

NOTERI — Vetëm?

TEFA — Lajdja e kputi qafën mbrëmë.

NOTERI — Mos flisni si rrugaçët, zotëri i dashur. (*sheh Fredën*) O; pse jeni prishur në fytyrë, vajza ime?

TEFA — (*ndërhyn*) Shqetësohet pér shëndetin e babës.

NOTERI — A të lumtë; bijë, të lumtë. Babai është ai që duhet të zërë vendin më të madh në zemrën tuaj.

TEFA — Më thua j diçka për testamentin, zoti Gaspër.

NOTERI — Presje.

TEFA — Ç'ka, presje?

NOTERI — Të thashë, gjeldeti vlen sa një presje.

TEFA — Oj!

NOTERI — Vazhdo të sjellësh biri im, e mos e humb durimin.

TEFA — (më inat) Do ta marr vesh edhe pa ty,

NOTERI — Kur? Kur të vdesë zoti Filip? Eh, budalla! Afrohu të të them diçka në vesh. Doktori më tha se është më i shëndoshë se unë (qesh)

TEFA — E pamundur. Ai parmbërëmë qe në grahmët e fundit.

NOTERI — Loje — teatër. Ke parë teatër ndonjëherë?

TEFA — Kam parë. Pse shtiret i sëmurë ai?

NOTERI — Për të shpëtuar kokën.

TEFA — Kokën?

NOTERI — Pse, mos pandeh ti se e falën komunistët? Ata janë të rreptë në këtë pikë. Po të dënuan me vdekje një herë, ehe, mos prit se do të shpëtosh, edhe sikur të futesh dhjetë pash nën dhe.

TEFA — (disi i trembur) Po, po... Domethënë së shpejti do të...

NOTERI — Vec, ssst! Edhe po t'i thuash gjë atij se unë... nuk qet gjë në dritë: unë e mohoj. Zoti ka krijuar mohimin, zotëri i dashur, për ta shpëtuar njeriun e shkretë nga e vërteta. Po të mos ishte mohimi, rrena, në shqip, unë, Noteri Gaspër Dredha, do ta ndjeja vetën shumë keq në këtë botë të pasbesë.

TEFA — Po dje pse të thirri?

NOTERI — Deri këtu tregimi qe gratis, pjesë tjetër ka shpenzime, djalë i mirë.

TEFA — Po të sjell edhe një gjeldeti.

NOTERI — Pse, një fuçi verë nuk mundesh? E keni verën të mirë.

TEFA — Nuk hyn minarja në thes, zoti Gas-për.

NOTERI — Fillo me damixhanë. Ë? Mirë, mendohu. Ki parasysh, zotëri i dashur, se ky lëng i jep krah punës. Mirupafshim! (*ngjitet lart*)

FREDA — (*befas ngrihet nga pianoja dhe ecën poshtë e lart*) Më vjen ta mbyt veten.

TEFA — Qetësohu, motër. (e përkëdhel.)

FREDA — Oh, vlla, vlla! (*i bie në parzëm*) E ç'kuptim kajeta kështu, brenda këtyre mureve, si në kuvend murgeshash?

TEFA — Dil, motër, dil.

FREDA — Ku? Për të parë njerëz të vrarë?

TEFA — Lufta i ka këto... Shko te tezja, dë-gjon? Atje, në fshat, të largohet mërzia patjetër, se-pse atje...

Ulet Liza.

LIZA — Eja në kuzhinë, zotëri, po deshe të hash.

TEFA — Erdha. (*i lëmon flokët së motrës*) Më prit këtu, Freda, e vazhdojmë këtë bisedë pasi të për-çap diçka. (*vrapon në kuzhinë pas Lizës*).

Freda ulet përsëri në piano dhe luan diçka të trishtueshme. Gjoni vjen nga lart me një kuti në dorën e majtë dhe në tjetrën me një shishe. Fishkëllen një melodi. Duket në qef, merr koburen. Ulet.

GJONI — Megjithëse sot ndërrova mendim, pra-pëseprapë po të mibush, që të jesh gati, moj virane.

Një ditë ndoshta do të më duhesh. Nuk do të kem nevojë të të mbush. (*Dëgjohen këmbë nëpër shkallë. E ka përfunduar mbushjen dhe e vë koburen ku ishte.*)

Ulen Filipi dhe noteri. Qeshin kokë me kokë.

NOTERI — Je mendjehollë, zotëri i dashur.

FILIFI — Ky zëvendësi i ri më qiti bishtë sot, hë: «Nuk është komunist i biri i Luigj Oshanit; s'ka si të jetë i biri i një tregëtari aq të madh». Iu gërmusha në telefon: «Arrestoje të them!»

NOTERI — Ai është kafshatë e majme.

FILIFI — Pasdreke eja e bisedojmë për këtë... (*i jep dorën*) Mirupafshim! Prit. Fol me doktorin.

NOTERI — Fola. Raportin e ka gati, e do ta marr, porsa t'i paguaj 300 napolona për komisionin.

FILIFI — Të hypë këtu e të shohë Stambollin.

NOTERI — Është punë me rrezik, zotëri i dashur, po ta hetojnë se raporti është falls. Ti ke vetëm një gjërvishje, nuk ke plagë...

FILIFI — Pusho! Nuk e sheh atë atje? (*tre-gon Gjonin*)

NOTERI — (*ndërron bisedë*) Edhe ky roja, që ka ardhur i ri, më kontrolloi sot. I thashë jam miku i majorit, por...

FILIFI — Jo roja, po tetari.

NOTERI — Ishte gazetar i madh. Kur i thashë se isha miku yt, ma priti: «Mik, mik, por po t'i ndodhë atij gjë, shkoj edhe unë në fik!» (*qesh*)

FILIFI — Ai është një kastravec faroç.

NOTERI — E di, më bëri shoshë për pak, dje...

FILIFI — Kam dhënë urdhër ta heqin, por ja, zvarrisen punët, se nuk jam unë atje, në krye.

NOTERI — (*lehtë*) He, ç'po thoni për ato 300 napolonat?

FILIPI — (e shikon shtrembër) Sa do të mbash përvete?

NOTERI — Jeeeezus! Pikën e besimit s'e keni.

FILIPI — Ti je si ajo ferra, zoti Gaspër; që ngado që të sillesh, shqyen diçka.

NOTERI — Për miqtë e bëj natën ditë unë.

FILIPI — Lëri përrallat. Do të të jap 100 na-polona. Jepu' nga 50.

NOTERI — Janë tre vetë.

FILIPI — Ndaji si të ta marrë mendja.

NOTERI — Nuk pranojnë, e di.

FILIPI — Mirë, do t'i fut në burg që të pranojnë.

NOTERI — A, jo, se atëhere i del içi raportit.

FILIPI — Ja, gjej grremçin; ua rregulloj procesin si komunista, e të hidhen përpjetë se nuk u beson kush më.

NOTERI — Nuk janë komunistë ata, i njeh tërë qyteti.

FILIPI — Po ty?

NOTERI — Ç'ka mua?

FILIPI — Të njeh qyteti se nuk je komunist?

NOTERI — Oh, dihet.

FILIPI — Po nipin që ke partizan?

NOTERI — E kam mohuar.

FILIPI — Për të mohuar s'e ke shokun ti, po varet sa të zënë besë.

NOTERI — E kam mohuar me gjithë zemër.

ROJA — (nga jashtë) Ndaaal! Tetari i rojes!

NOTERI — Sa më futin frikën, kur çirren kësh-tu këta xhandarët.

FILIPI — Për atë paguhën. Shko, zoti Gaspër. Ditën e mirë.

NOTERI — Raportin e lامë pezull, zotëri i dashur.

FILIPI — Bëj ashtu si të thashë.

Hyn tetari, përshëndet.

TETARI — Zoti major, qarkomandanti ynë trim e i mendshëm, unë, ushtari juaj besnik, vij dome-thënë të të lajmëroj, se një i panjohur, tentoi të kallonte prakun e derës së zotërisë suaj, me qëllime që dihen: për t'ju parë ju, zoti major, si jeni, ku jeni, për t'ju dorëzuar një dhuratë që, më falni, është një qengj dhe për të biseduar për punën e një toke. Kësh-tu, këto që dihen. Por ne, që rrimë syhapur për të ruajtur jetën tuaj të vyer e që po ju them këtu në sy të zotërinjve dhe zonjushes, shohim qëllimet e fshehta, se unë, që ta dini, jam mësuar me njerëzit kur janë të kqinj, zoti major edhe ju zotërinj dhe zonjushe, kur janë të kqinj, kanë diçka në fytyrë, si puna e asaj mjegullës, domethënë, ose si puna e reve, më mirë që, megjithëse është ditë, ë? Ti thua ditë, po nuk mund të thuash ditë e mirë. E pse? Se-pse janë retë. E shikoni domethënë, ku është kokrra. Prandaj, vendosëm, zoti major i dashur, i mend-shëm dhe trim, vendosëm unë ushtari juaj besnik edhe roje atje, a më mirë, unë si epror i tij, unë pra, domethënë vendosa, që të mos e lë të hyjë këtu, duke pasur parasysh, sa thashë, për ruajtjen e jetës së vyer të zotërisë suaj të nderuar. Kaq. Pres urdhërin epror, domethënë.

FREDA — (qesh) Oh, babi, më fal, po kudo unë, si folka ky! . . .

FILIPI — Dëgjo, more kastravec faroç, a të kam thënë të mos më dalësh në sy?

TETARI — Si urdhëron, majori im zotëri, ma keni thënë, domethënë, e ëdhe që dje nuk ju kam dalë, e as që e kisha ndër mend ta thyjeja urdhërin tuaj të nderuar, por... por, më detyruan mua të gjorin.

FILIPI — Mjaft, mjaft. Ec këtu! Afrohu! Hukat, hukat. Jo andej, more kastravec faroç, por këtej, në drejtim të hundës sime. Ashtu. Eee, ke pirë, pifsh helmin që të mbyttë, pifsh ujët e detit, lugat. Ku e ke marrë, ose ku e merr verën që pi, derr? Fol se ta nxora shpirtin!

TETARI — Oh, oh, oh, zoti major, më lëshoni; se ndryshe fjala e shkretë nuk ka fuqi të dalë prej qafe në gojë. Po, i nderuari zotëri, po: i ratë në të, alkool është, i lumtë hundës suaj të mendshme që, domethënë, aq bukur e me shkathësi e kap erën e alkoolit në gojén time. Por, më falni, më falni, më falni tri herë, sepse unë, ushtari i juaj besnik, po detyrohem edhe kësaj here t'jua bëj fjalën dysh. Jam i detyruar të veproj kështu, më kuptioni, ë? Edhe dje ju thashë, e ju sqarova fare mirë, se ky lëng që bie erë, ose era që paditë lëngun, është alkool vërtet, po, domethënë, alkool, por jo për të pirë, por alkool nevoje, alkool që e vë në buzë vetëm për të paqtuar dhembjen e dhëmballës. Oh, oho, oh, veç unë jam i fortë se guri, zotëri major se, po të ishte një tjetër, ehe, do të ishte shtrirë diku, kudi unë ku, por do të ishte i shtrirë duke rënkuar aq shumë, sa t'i dhembet gurit e drurit.

FILIPI — Pusho! Mbylle t'u mbylltë përgjithmonë, o gojëçorape, i pafytyrë, hor, qen, maskara, hajn i pangopur, sfyngjer vere, lubi! Ti e ke gjetur ndonjë birë miu në kantinë, e hyn bën kërdinë në verën time.

TETARI — Jo, jo, jo, betohem për nderin tim
të ushtarit besnik, jo, jo, jo!

FILIPI — Jaaashtë, kpute, thashë qafën!

TETARI — Ju lutem zoti major, më jepni leje
të largohem, kështu si erdha, më falni, me një shirit
domethënë: tek, por me shpresën e madhe në zemrën
time prej ushtari besnik, se do të bëhet çift, do të
bëhet çift, se bujaria juaj, mendja juaj trimëria juaj
është...

FILIPI — Oh! (*bie mbi një karrigë*) Ujë!

FREDA — Babi!

NOTERI — Ujë, shpejt ujë!

GJONI — (*qesh*) Vazhdo, tetar, mbaroje fjalën
se po të dëgjoj unë, me që baba ka sekëlldisje.

TETARI — Zotëri i nderuar.

TEFA — (*e kap për krahу*) Shko, shko!

FREDA — (*vrapon në kuzhinë*) Ndoc, Lizë, ujë...

TETARI — Mos kap zotëri, se kjo rrobë nuk
kapet, sepse ku shkon nderi i ushtarit besnik atë-
here?

TEFA — Ik, pra.

TETARI — Dale të përshëndes eprorin tim, do-
methënë.

GJONI — Më pëlqen shumë ti, tetar; do të vî
atje të rrimë dhe të pimë bashkë.

TETARI — (*merr qëndrim gatitu, pëershendet*)
Me urdhërin tuaj, zotëri major, të pashprehur nga go-
ja juaj e nderuar, por të nënkuptuar prej meje, te-
tarit këtu, po largohem pa marrë udhëzimet e ne-
vojshme, lidhur me atë fshatarin dhe qengjin. (*del*)

FREDA — (*sjell, duke rendur një gotë ujë*) Pije-
babi, është limonadë.

FILIPI — (*pi, pas pak*) Shkoi?

NOTERI — Si urdhëron, e theu qafën, si thatë ju.

FILIPI — Oh zemra... Eh! Zoti Gaspér, ai nuk ka faj ta dish, nuk ka faj. Çudi e madhe! Nuk e kupton se atë e kanë dërguar këtu pikërisht që të më shtojnë edhe një torturë, se ata, armiqtë e mi, e dinë se zemra ime, pas plagosjes, éshtë bërë si puna e atij sahatit që e ka zemerekun të plasur... e ky, tetari, qeni, me ato marifetet e tij, do të ma thyejë zemerekun, e kështu të më pushojë zemra. Kjo éshtë llogari e thjeshtë, që unë e kam kapur shpejt, se gjithë puna éshtë te nuhatja... (*Vjen Ndoci me zarf në dorë. Ja jep Filipit*) Kush tà dha?

NDOCI — Tefa, zotëri. (*Tefa vjedhtas del jastë*)

FILIPI — (*e hap zarfin. Noteri e zgjat qafën dhe shikon letrën, por vrikthi tërhiqet i trembur.*) Ç'patë?

NOTERI — Nuk e shihni atë kafkën?

FILIPI — E pastaj?

NOTERI — Lexoje, zotëri.

FILIPI — (*pas një heshtjeje*) E lexova. Komunistët! (*qesh*) Ata mjaft të kqinj janë, zotëri Gaspér, — u shofshin! — por punë kusarie nuk bëjnë. (*gris letrën*) Këtë punë e ka bërë ai im bir, Tefa... (*e kërkon me shikim nëpër sallon*) Po meqë éshtë pa zarar, nuk po e çoj më gjatë: po e fal. (*Gjonit*) Ec këtu, biri i babës. (*sheh shishen*) Ke pirë? Të bëftë mirë, pi. Edhe unë këtë bëja kur isha i ri, zotëri Gaspér. Kam pirë njëherë një damixhanë verë. Edhe dëgjo: nuk u deha. Çudi e madhe, ë? Iu afrova fuçisë, yura buzët te cepi: èfff, èfff: thitha. Ku di unë sa piva, veç mbaj mend që të nesërmen më patën gjetur atje poshtë, në kantinë.

NOTERI — Keni patur trup tē lidhur, zotëri.

FILIPI — Div kam qenë.

NOTERI — Edhe je.

FILIPI — Nuk është e vërtetë, pas plagosjes u rrëzova shumë... zemra.

NOTERI — Eh, po tē ishte e mundur tē hiqja zemrën time...

FILIPI — Lëre, zoti Gaspër, mos u harxho tē njoh se je bujar (*qesh*)

GJONI — Babë.

FILIPI — Fol.

GJONI — Dua 1000 napolona tē hap një dyqan... U bëra derr pa punë. Po tē jap edhe garanci që do t'i kthej. Noterin e kemi këtu.

FILIPI — E gjete kohën tē hapësh dyqan. Edhe ata që i kanë, po i mbyllin, more bir. Pastaj, nuk kam asnijë grosh, pyete zoti Gasprin.

NOTERI — Nuk ka pasur kurrë.

FILIPI — A mund tē mbahet me një rrogë tē vogël gjithë ky kallaballëk? Thashë rrogë tē vogël, sepse paguhet me këtë dreq kartmonedhë që bie çdo ditë e më poshtë. A, po tē ishte në ar, ndërron puna. Ari, hë, ari tē mbush kuletën e nuk njeh luftë ai. Ai bën mrekullira. Po tē mos e dija se ka zot, do t'i falesha atij, zoti Gaspër.

NOTERI — Uh! (*bën kryq*) C'flisni ashtu si filistin, zotëri!

FILIPI — Eh, ky! (*qesh, Gjonit*) Ky Gaspri, që duket si kallam, ka shkollë tē madhe jete. Nuk është keq tē mësosh prej tij, biro. E ka nisur prej asgjëje, e sot, po t'i mbushet mendja, e blen krejt lagjen tonë.

NOTERI — Kafshata e tjetrit duket gjithmonë e madhe.

GJONI — Babë, do të m'i japësh?

FILIPI — Unë shqip fola.

NOTERI — Nuk ka...

GJONI — Po paret që nxore nga rrushtë e vreshtit ku fluturuan?

FILIPI — Lava borxhet.

GJONI — Borxhet? Mos do të thuash se edhe shtëpinë, edhe tokat edhe vreshtin e kemi vënë peng?

FILIPI — E di ky.

NOTERI — Peng, peng.

GJONI — Genjeni!

FILIPI — (*i bie shputë*) Mëso të flasësh para meje, qen!

NOTERI — Zotëri!

GJONI — Gënjen! Ti do që ne të mbetemi me gisht në gojë, në rrugë të madhe sepse Lajdja...

FILIPI — Pusho!

FREDA — Oh, babi, mos e prish gjakun, të lutem.

FILIPI — M'u hiq edhe ti! (*e shtyn, e ndjek Gjonnin, ai del jashtë. Freda ulet në piano dhe i bie.*) Gaspër, Gaspër, mos u anko se nuk ke fëmijë. Eh, sa kam shpenzuar pér t'i rritur, pér t'i bërë kaq me shkollë, pér besë, milioner do të isha. Ja, si ta shpërblejnë. Babai, zoti Gaspër, éshtë si ai gomari, që mban verë dhe pi ujë. Kurse unë, kurse pér ta, e jeto si qen... Kam dëshiruar gjithshka... E pse? Që të mos vuajnë këta. E ja, ja si ta shpërblejnë. E pe?

NOTERI — (*kinse i dëshpëruar, ofshan*) E pashë. Po duhet të kesh besim tek ai i lumi atje lart, që i gjykon punët tonë me drejtësi të madhe.

FILIPI — E përse të kem besim?

NOTERI — Një ditë fëmijët tuaj do të vihen në rrugë të mbarë...

FILIPI — Asnjë ditë. Moti i mirë shihet në mëngjëz, zoti Gaspër. (*Fredës*) Lëre, moj, atë dreq piano, se m'i nxore mendtë në tring, tring, tring; tërë ditën.

FREDA — Ah, babi, po të mos ishte kjo, do të çmendesha!

FILIPI — Oh, po pse gjithë ky zor, bre? Ti përtë ngrënë ke, e veshur si ti askush, fle në dyshek me pupla, e ç'të mungon, bijë?

FREDA — Gjithshka... (*i bie në parzëm, qan*)

NOTERI — Ke vajzë të mirë, zoti Filip.

FILIPI — E kam dashur gjithnjë.

NOTERI — Freda e ëmbël i thoshe.

FILIPI — Do t'i gjej një burrë kësaj, që...

NOTERI — Atë përtë cilën biseduam...

FILIPI — Kur? (*Noteri i luan syrin.*) Ah, po.

NOTERI — Djalë xhevahir.

FILIPI — Edhe prikë do t'i jap shumë. Kështu të pastë babi.

FREDA — Ti je i mirë (*e puth*) Ne jemi të ligj, sulemi përtë të nxjerrë sytë përtë hiçgjë.

FILIPI — Ah, bijë, ani: zemra ime fal.

FREDA — Babi, a mund ta di kush është ai djalë?

FILIPI — Durim, bijë, durim, do të vijë dita dhe do ta dish.

NOTERI — Do të të shohim nuse së shpejti. Do të jesh më e lumtur se me atë italianin, si i thoshin.

FREDA — Oh! (*qan*)

FILIPI — (*rreptë*) Gaspër, Gaspër, po i the me qëllim poshtërues këto fjalë, nuk del i gjallë prej këtej.

NOTERI — Më vraftë zoti, në i thashë me qëllim të keq. Ai italiano...

FILIPI — Lëre! Ne e kemi harruar, ai ka vdekur.

NOTERI — A, paska vdekur. Po më vjen mirë, zotëri, se vajzës suaj ja punoi keq.

FILIPI — Uh, çudi e madhe! Unë i them lëre, ky të tijën se të tijën. E sheh këtë duke qarë? Apo si duket, ke qejf ta provokosh zemrimin tim, e? Ssst! Pusho, të them!

NOTERI — Zotëri, unë nuk jam tefari.

FILIPI — Edhe më i keq je.

NOTERI — Falemnderit; nderon gojën tënde (*niset të dalë*)

FILIPI — Prit! Na jep dorën. (*ja shtrin të veten*)

NOTERI — Ti kështu e ke zakon: mbasi të mbath mirë e mirë, atëhere shtrin dorën. Sikur nuk ke qenë ti ai...

FILIPI — Lëri fjalët! (*së bijës*) Freda ime eëmbël, qetësohu. Shko lart, laj fytyrën, se lotët të kanë zhgaravultur, edhe ti, të marrtë e mira, vë shumë pudër (*e përkëdhel*.) Hajt, shko, freskohu. (*Freda ngjitet lart*.)

NOTERI — Përi ato paret e raportit.

FILIPI — Pasdreke.

NOTERI — Mirë; po t'i japim fund, ë?

FILIPI — Toke (*i shtrëngon dorën*). Prit se porrimë pak në lulishte. Pimë edhe një kafe. Hë de, mos rri ashtu i mvrejtur.

NOTERI — Unë nuk jam si fletët e mullirit, zotëri, që sillen nga fyrn era!

FILIPI — Do të kalojë, do të kalojë... Lizë! (*Du-*

ket Liza.) Dy kafe turke. Na i sill atje, në lulishte.
(Gjoni ka hyrë, ka marrë shishen dhe rri prapa) Mos
më rri pas shpine me atë shishe në dorë.

NOTERI — Edhe unë e kam frikë, zoti Filip, pam! Në çafkë të kokës edhe në tokë. Është kokë, nuk është shkëmb.

FILIPI — Dil përpëra.

GJONI — Dyshon?

FILIPI — S'i ze besë as hijes sime unë.

NOTERI — I ke shakatë të rënda, zotëri.

FILIPI — Nga shakatë e këtij malukati, gati më pushoi zemra dje.

GJONI — U trembe nga britma e Lajdes.

FILIPI — Zonja Lajde thuaj, qen! Ssst! Pusho!
Çudi e madhe! (*Dalin*)

Tefa del nga kuzhina, ndërsa Freda zbret nga lart.

TEFA — Dështim i plotë. Më mori në qafë Ndoci, e marrtë e mira! Po, ani, ngushllohem, motër, ngushllohem që sot jam qefull. Prandaj kam mundësi t'i shkruaj Karolinës sime. Hej, ç'vajzë ishte! E holë, e gjatë, e bukur-romanjola. O, ç'zë kishte ajo... Stefano, Stefano! cicëronte. E desha aq shumë, sa, një ditë, edhe pse i kisha të pezmatuara këto të bekuara (*preke fytin*), dola nga kolegji dhe vajta tek ajo. U kujtova, pasi kisha bërë gjysmën e rrugës, se po binte shi. Kur më pa, u hodh përpjetë nga gëzimi, por befas nisi të qante: «Oh, Stefano, ç'je bërë kështu?» Unë kulloja aty në dhomë, si të isha ulluk pullazi (*qesh.*) Të më shihje me robdëshambrin e saj, Freda, do të shqyeheshe gazit... Eh, dashuri, dashuri! Është pasion i fortë dashuria, motër, tëçon te vatri, e ti, paditur se është hapur për ty, kërcen valle nga kënaqësia (*i rrëmbyer nga kujtimet eëmbla.*) Eh,

Karolina, Karolina, ku tē shkel këmba tani, moj zeshkane! (këndon.:)

Karolina; karola
son tre or'ke sono kua:
Il mio kuor mi fa
Tiki tiki ta-tiki tiki ta!

Del nga kuzhina Liza, me një tabaka ku shihendy filxhanë.

LIZA — Zonjushe, shko e ha mëngjezin.

FREDA — Nuk dua.

LIZA — Mirë (shkon në lulishte)

Vjen Gjoni nga jashtë. Është serioz, hijerëndë, u afrohet Tefës dhe Fredës.

GJONI — Uluni! (Ata i binden, tē shtyrë nga kurreshtja për tē ditur shkakun që fsheh në vete ajo çehre e tē vllait. Ai flet sikur po zbulon sekretin më tē madh tē jetës së tij.) Babaj nuk do tē vdesë!

TEFA — Këtë e di.

FREDA — Aq më mirë.

GJONI — Po nuk lëvizëm, do tē vdesim ne para tij.

TEFA — Çfarë mendon tē bëjmë?

GJONI — Ta mbysim në gjumë.

FREDA — Ah!

TEFA — Mos bërtit, moj!

FREDA — Unë nuk vë dorë mbi tatën, kurrë. Po tē më mbytë, i puth dorën.

TEFA — Mua do tē më vinte mirë tē vdiste, se, tē flasim tē drejtën, ë? E ka tepruar. Po, po, e ka tepruar. Duhet tē na lëshojë vendin. Kështu është

kjo: stafetë. Dorëzoje me kohë, se pastaj vjen puna që ta lusin mortjen.

GJONI — Mos të presim sa ta dorëzojë vetë.

FREDA — Turp të keni! Kjo është një mëkatë që s'e mbart dheu, vetëm ta mendosh... (*largohet. Gjoni i vihet prapa dhe e kap për dore*) O lëshomë se ma përdrodhe!

GJONI — Po na tradhëtove, të mbys!

FREDA — Nuk flas, jo, po më lësho.

GJONI — (*e lëshon. Ajo del jashtë, ky qesh me tē madhe.*) *I t a l i !* Ja, erdhëm (*e përqafon Tefën*).

TEFA — (*vëren i habitur dhe nuk kuption shkakun e këtij ndryshimi*). Ku e sheh Italinë, Gjon?

GJONI — (*e merr për dore dhe e afrom te dera e sallonit*) Ja! (*i bën me gisht në një drejtim*).

TEFA — Freda?

GJONI — Ajo do të veprojë mbi babën, sipas parashikimit tim...

TEFA — Nuk kuptoj asgjë.

Dëgjohen pushkë. Freda klith dhe turret brenda.
Pas saj vjen zoti Filipi, lëshohet në një poltronë.

FILIFI — Ujë... Ujë!

FREDA — (*fshihet diku*) Ujë... ujë!

TEFA — Pritni, bre, sa shpejt ju ka marrë etja.

GJONI — Po sikur të hyjnë këtu?

TEFA — Mos ma fut frikën, të marrtë e mira.

FILIFI — Ujë... Ujë, he ju shtifsha në dhe.

Vjen Liza.

TEFA — Lizë, sillja një gotë ujë babës.

FREDA — Edhe mua.

GJONI — Edhe mua.

TEFA — Edhe unë e pi, Lizë. (*Liza shkon në kuzhinë*).

ROJA — (*nga jashtë*) Ndaaal! Tetari i rojes.

FILIPI — E pat...

TEFA — Krismat pushuan.

GJONI — Prit kur të fillojnë në oborr.

FILIPI — Hesht, qen!

(*Hyn oficeri. Dihat, duket që ka vrapuar*)

TOGERI — Zoti major...

FILIPI — (*kur e sheh, e merr veten*) Hë, more, fol!

TOGERI — Tre të burgosurit ë dënuar me vdekje i grabitën partizanët.

FILIPI — Po ju ç'bëni, vrisni miza?

TOGERI — Ç'të bënim kur ata kishin urdhërin tuaj në dorë?

FILIPI — Me firmë e me vulë?

TOGERI — Me firmë e me vulë.

FILIPI — (*qesh*) Po si e gjete.

TOGERI — Kur e kuptuam se ishte fallso, iu vumë prapa.

FILIPI — Rezultati?

TOGERI — Asgjë.

FILIPI — Mos bëni, more, zhurmë me ato drejt pushkë, se jo vetëm trembni miletin, por edhe harxoni fishekët kot.

TOGERI — Po unë nuk erdha për këtë, zoti major. Më dërgoi princi t'ju thërras në emër të kolonelit Brynger. Do t'ju shoqëroj deri në Gestapo...

FILIPI — (*mbetet keq, e pasi mendon*) Koloneli po pati bisedë me mua, të urdhërojë këtu dhe është i mirëpritur, se unë, me trupin shoshë nga plumbat dhe me zemrën çyryk, nuk mund t'ja plotësoj dëshirën në asnje mënyrë. Oh! Po ti nuk e di, toger, gjendjen time?

TOGERI — Domethënë nuk vini?

FILIPI — Oh, kërcënim éshtë ky, çudi e madhe?

Ik, mik, se më trëmb. E di se je gjerman safi, por
nuk më tremb.

TOGERI — Atëhere do të vijnë t'ju marrin...

FILIPI — Oh! Zemra... zemra... Sillmani ujët,
bre, sillmani!

FREDA — Tani, babi, ta sjell Freda ty. (*Oficeri
del, Freda shkon në kuzhinë*).

GJONI — (*Tefës lehtë*) Si duket, po mbaron lo-
ja vetë.

TEFA — Gjermanët... babën... kaput?

GJONI — Fiu!

FILIPI — Pushoni!

Perdja

GJONI — Ipus

TEFA — Ipus

GJONI — Në mëdum

TEFA — Përtaq së putojnë i përmë Zaper

GJONI — Molopështë

TEFA — Nuk si mësor. E ndërsa përgjigjet këtu ujë-

tësill është qenur të shpërndarë poshtë së marrëdhënia

GJONI — (basi mundon) Tani është së shpërndarë

TEFA — Tani mund të shpërndarë Tefës

GJONI — Në çfarë

TEFA — Më që të mëndjeshat

GJONI — Më Tefës

TEFA — Tani së mëvendosje që t'ia

gjithëpërfshirë, që t'ia bëj që t'ia bëj përmes

Zapështësuar, që t'ia bëj që t'ia bëj përmes

Zapështësuar, që t'ia bëj që t'ia bëj përmes

AKTI I TRETE

Lulishte. Mbrëmje. Gjoni ka në dorë shpatën që kemi parë në sallon. Me një limë, hollon tehun dhe majën, i përqëndruar. Herë pas here nxjerr shishen nga nëntavolina dhe pi.

Nga jashtë vjen Tefa. E ka mbështjellë qafën mirë, ndalet e kundron vllanë në heshtje, plot habi dhe frikë.

GJONI — Ishe?

TEFA — Isha.

GJONI — Në rregull?

TEFA — Biletat për motobarkën i bleu Zyber agai.

GJONI — Motobarkën?

TEFA — Nuk ka vapor. Edhe me këtë ikin njerezit, që duan të shpëtojnë kokën nga partizanët.

GJONI — (*pasi mendon*) Fundi, të shkojmë në Itali, kjo ka rëndësi. Tjetër?

TEFA — Pasnesër niset.

GJONI — Në ç'orë?

TEFA — Në 4 të mëngjezit.

GJONI — Mirë. Tjetër?

TEFA — Paret e nevojshme për udhëtim, tha Zyber agai, jua jep kur të bini fletëgarancinë që ju kam kërkuar.

GJONI — E mora vesh.

TEFA — Me këtë? (*bën shenjë pér shpatën*)

GJONI — Me këtë.

TEFA — A nuk është e madhe?

GJONI — Kaq duhet.

TEFA — Çfarë do t'i bësh?

GJONI — Do t'i heq kokën.

TEFA — Oh!

GJONI — Pastaj do t'i heq krahët: krrap, krrap-

TEFA — Oh, oh!

GJONI — Pastaj dy këmbët.

TEFA — Ububu!

GJONI — Pastaj... Asgjë: mbaron.

TEFA — Nuk mjafton t'i heqësh vetëm dy kokat?

GJONI — Mjafton, por krahët e këmbët ja heq që ta kem më kollaj pér ta futur në thes.

TEFA — Në thes?

GJONI — Nuk ka arkivol pér të. Do ta hedh në lumë si qenin.

TEFA — Bëlldum?

GJONI — Bëlldum.

Freda i bie pianos dhe tingujt vijnë deri në lullishte.

TEFA — (*dëgjon pér pak e, papritmas, i lindi një mendim.*) Po të na padisë Freda, plaku na e bëri të zezën fët e fët.

GJONI — Pikërisht aty qëndron loja ime.

TEFA — Loja?

GJONI — Ka mundësi që plaku të mbytë veten.

TEFA — Plaku, veten? Asgjë nuk kuptoj.

GJONI — Durim.

TEFA — Nuk do ta... ti?

GJONI — Unë? Nuk jam i zoti të mbys as edhe një mizë...

TEFA — Tallesh? Jo, unë një pulë e mbys duke fishkellyer. Po ti tallesh, e di unë, se kur ke qenë atje, në Vlorë, ke bërë njëmijë të kqia... (*Nga saloni vjen Filipi. Ka ngjyer flokët, po mustaqet i ka të bardha. Dicka i thotë Ndoci, që i shkon prapa e qesh. Duket shumë në qef.*) Babai, fshihe shpatën.

GJONI — Aspak.

TEFA — Na more në qafë!

GJONI — (*vëren Filipin*) Matufi, i paska lyer flckët.

TEFA — Do t'i duket Lajdes i ri.

FILIPI — (*pasi përcjell Ndoci*) He, bijtë e mi! Tefë, bjerë faqen këtu (*e puth*). Nuk të kam parë që në mëngjez. Je i mirë ti, i pafjalë. Ty, Gjon, nuk po të puth; para dreke më ke ngelur një shputë borxh (*qesh*) C'po bën kështu?

GJONI — Po ja heq ndryshkun.

FILIPI — Bukur, të lumtë! Ja, kësaj i thonë të vlerësosh traditat e familjes sonë. Ajo ka qenë shpatë e të ndjerit babës tim, gjyshit tuaj. Bjere këtu (*le merr në dorë dhe mban një qëndrim madhështor, epik*). Me këtë shpatë i ndjeri baba im, — gjyshi juaj kushedi sa krerë turqish ka prerë... atje në Kosovë, në mos gabohem. Thonë se kjo virane qitte zjarr në dorën e tij. Një gjë éshtë e vërtetë, fëmijët e mi: Loro Babuna ka qenë trim me fletë.

TEFA — Thonë se...

FILIPI — Rri ti.

GJONI — Edhe në picturë duket... (*Kthehet Ndoci, e pret në këmbë*.)

FILIPI — Burrë i pashëm e i mendshëm. Ka pasur sy të mprehtë ai, sikur të ishte ndonjë skifter. Thonë, se shikimi i tij të shponte si tyrjelë. Mustaqet e zeza si pendët e korbit, gjoksin, naaa, kaq, sa të Mu-jit. I kishte krahët sa... Me çfarë t'i krahasoj?

NDOCI — Me dy lopata, zotëri.

FILIPI — Shiko ti, mos merr nëpër gojë babën, se të pret e zeza.

NDOCI — Unë pa të keq e thashë sepse edhe lopatat...

FILIPI — Shët, mbylle të thonë!

NDOCI — Më falni, zotëri.

FILIPI — (përqesh) Më falni, zotëri, më falni, zotëri, deri kur? Hesht po të them. Kupa t'u mbush, ta dish, por, po nisi të derdhet sadopak, të pret mani atje. Ja...

TEFA — Mëshirë, babë! (*Tingujt e pianos bëhen edhe më të fortë*)

FILIPI — (Ndocit) Shko e i thuaj asaj marro-qes, ta lejë pianon, se na i nxori mendtë. Vrap! (Ndo-ci ikën)

TEFA — Pastaj, babë?

FILIPI — Eh, ç'na e prishi gjakun ky harbut! I fut hundët kudo, qeni! Çudi e madhe! Liria i bas-tardon këta kokë kosha. E... ku e patëm? Ishte burrë i madh, si ata dy divat, që tregohen ndër përralla.

GJONI — Në pikturë duket imcak.

FILIPI — S'do mend, po ta piktonin siç ishte, në çfarë kornize do ta futnin? Ë? Ty po të vyes, se gjithnjë më fut thumba ti... Kujton se më shpëton gjë mua? Hëm! Qen! Mirë, e gjetën kornizën, po ku ta varin? Ku ka mure dhomë ose salloni këtu në Shqi-përi, aq të mëdha dhe aq të larta? Eh, ka qenë burrë i rrallë ai; thonë se dy burra i ka çuar peshë:

vaaap! (*Pushon pianoja*) Do ta thyej atë piano.

TEFA — Ti flet, baba, e mua më mbushet zemra plot krenari.

FILIPI — Kur i kam dëgjuar edhe vetë këto, më eshtë ngjethur mishtë. Thoshja me vete: «A do të bëhem ndonjëherë burrë, që t'i tregoj botës se jam i biri Loro Babunës?» Për hir të së drejtës duhet thënë se emrin e tij e kam ngritur lart. Sa ai nuk kam bërë, po afër i kam shkuar. (*prek me bulën e gisshit tehun e shpatës*) Mos e mpreh kaq, more ti. se kjo vetëm pér zburim duhet tani.

GJONI — (*enigmatik*) Mund të duhet edhe përtjetër gjë.. .

FILIPI — Për të prerë ndonjë dash. (*qesh*)

GJONI — (*s.n.*) Mundet... (*çohet*)

FILIPI — Nuk do të ishte keq, por jo nga vatha jonë.

Nga dera e oborrit hyn noteri. Gjoni shkon në shtëpi, duke tundur shpatën.

NOTERI — Mirëmbërëma!

FILIPI — Eja, zoti Gaspër, se po të pres me padurim. Ulu. Ma jep dorën. A u lodhe? Po bisedoja me çunat e mi. Ta them si miku mikut, sonte u knaqa me ta... Hë, ç'shikon ashtu?

NOTERI — Shpatën.

FILIPI — Eshtë e babës tim, të ndjerit.

NOTERI — Si urdhëron, e di... ma ke thënë... Por atij Gjonit nuk bën mirë që ja lëshon në dorë.

FILIPI — Hej, more Gaspër, si të shkon mendjë gjithnjë tek e keqja! Shpata nuk pi ujë më. Eshtë koha e pushkës tani.

NOTERI — Si urdhëron, zotëri i dashur, push-ka, por ajo shpata të mbyt pa zhurmë.

FILIPI — Lëre. Fol, ç'kemi?

NOTERI — Fola me të jatin e ati djalit, Luigj Oshanin. I thashë se po bëhem ndërmjetës tek ju, për t'ja liruar djalin nga burgu. Më falënderoi, madje më përqafoi; por kur i përmenda shumën, u step: «Jo — tha, — për aq të rrijë aty.

FILIPI — Aty jo, por do t'ja zhduk farën në Gjermani.

TEFA — Fol, babë.

FILIPI — Qërohu ti!

Tefa largohet.

NOTERI — Merreni më shtruar, zotëri i dashur.

FILIPI — Ah, mirë që m'u kujtua. O Ndoc, Ndoc more!

Duket Ndoci.

FILIPI — Merre atë gjeldetin e majmë, që kam ndarë mënjanë, të kujtohet? Çoje te zonja Lajde. Ka ditën e emrit nesër, Gaspër, e ka thirrur miq e dashamirë. Po kur nuk jam unë aty, nuk i qesh buza të ngratës. Ti e di, nuk mund të dal, nuk mund të lëviz nga plagët. Oh, oh, oh!

NOTERI — Ruajeni shëndetin, zotëri i dashur.

FILIPI — (Ndocit) Je shurdhuar? Ç'më rri ash-tu si statujë?

NDOCI — Atë gjeldetin, që thoni zotëria juaj, ka gati një muaj që nuk e kam parë.

FILIPI — Pse, unë e di se ku është?

NDOCI — As unë nuk e di.

NOTERI — E keni harruar derën çelë...

FILIPI — (ironik) E gjete. Dera ime hapet e mbyllët vetëm kur del e hyn njeri. Ç'bën ai xhandari aty? Plas kokën në daç dhe nxirr trutë, por gjeldetin e dua prej teje!

NDOCI — Veç po të bëhem unë gjeldeti.

FILIPI — Bëhu.

NOTERI — E kam unë një gjeldeti në shtëpi, të majmë. Nuk ta shes shtrenjtë zotëri i dashur.

FILIPI — Faleminderit, kam timin.

NOTERI — Edhe babën e ke pasur dikur, zotëri i dashur...

FILIPI — Kush dreqi e ka marrë?

NOTERI — A kryejmë punë, se nxitohem?

Vjen nga dera e oborrit tetari. Diçka i thotë rojes nën zë, pastaj afrohet te Filipi, nderon.

TETARI — Më falni, që po ju prish bisedën, zotëri, por një detyrë e veçantë më detyron, dome-thënë, më detyron, sepse, që ta dini, zoti major, unë ushtari besnik i qarkomandantit të ri, domethënë, i atij nénkolonelit, të cilit ende emrin nuk ja di por që ju siguroj se do t'ja mësoj së shpejti, largohem prej jush me keqardhje, jo për punën e atij shiritit që nuk ma dhatë...

FILIPI — Prapë paske pirë, maskara?

TETARI — Aty ta kisha fjalën, domethënë, më vjen keq të largohem, sepse në qoftë se ju jeni i keq, zoti major, verën e keni shumë shumë të mirë.

FILIPI — Ah, e pohove me gojë tënde. Roje! Arrestoje këtë kafshë!

NOTERI — Zotëri i dashur, ai tha fjalë të mira për verën, gjë që e kam thënë edhe unë disa herë.

TETARI — Thashë, sepse malli i mirë flet vetë, domethënë, ashtu si edhe malli i keq... por, si i thonë asaj fjale, mallin e keq s'e blen njeri. Tani më lejoni të largohem, ju lutem shumë, se kemi punë gjetiu.

FILIPI — Kpute!

TETARI — Mirupafshim. (*i shtrin dorën*)

FILIPI — Nuk dua të ta shoh bojën.

TETARI — Nuk do të ma shihni, domethënë, sepse nuk do të kem më punë me ju, pasi siç tha edhe zotëri togeri, ju jeni një gjenjeshtar, prandaj edhe koloneli Brunger ju hoqi nga vendi i komandanit, e, si tha togeri, s'është çudi t'ju fluturojnë edhe gradat, sepse po bëhen hetime për të zbuluar lidhjet tuaja me komunistët. Të gjitha këto po jua them, domethënë, vetëm e vetëm, që të kryej de-tyrën e fundit kundrejt jush. Ika. (*largohet, merr edhe rojen dhe dalin. Heshtje e gjatë*).

FILIPI — Mirë që e thyen qafën; ma kishin prurë në majë të hundës. Me siguri do të dërgojnë të tjerë.

NOTERI — Nuk e dëgjove se ç'tha?

FILIPI — Ai ishte i pirë.

NOTERI — Zotëri i dashur, këto fjalë qarkullojnë edhe në qytet nga njerëz esëll.

FILIPI — (*ja ka ngulur sytë*) Ti knaqesh?

NOTERI — Ku e sheh knaqësinë, zotëri i dashur?

FILIPI — Ndër sy.

Vjen Freda.

FREDA — Dua të bisedoj sa më parë me ty.
FILIPI — Nuk sheh se jam i zënë? Nuk mund
të bisedoj në një kohë me dy njerëz.
FREDA — Mirë, po të pres. (*largohet*)
FILIPI — (*Gasprit*) Megjithatë, kam nevojë për
ty...

NOTERI — Nuk më ka bërë lopa muq, zotëri.
FILIPI — Ulu.
NOTERI — Kam punë.
FILIPI — U zemrove?
NOTERI — Ti kujton se të tjerët nuk kanë gjak,
por kanë ujë ndër deje.

FILIPI — (*çohet, e përqafon*) Po ne jemi buka e
një mielli, Gaspër, mos e harro këtë, sot unë për ty,
nesër ti për mua. Ulu, se kam një bisedë me rëndësi.
(*Gaspri ulet*) Mbrëmë mora vesh ca lajme të papël-
qyera. Partizanët kanë zaptuar gjysmën e Tiranës!
Priti këtu në fund të muajit. Pra, sa nuk është vonë,
duhet t'ja lë hijen këtij qyteti, e madje, Shqipërisë.
Shko e thirre atë barkaxhinë, Zyber Aganë. Do t'ja
mbath për Itali. Po deshe eja edhe ti.

NOTERI — Jo, falemnderit, jam mirë këtu.
FILIPI — Punët janë ngatërruar aq shumë, sa
nuk është çudi ta pësosh.

NOTERI — E di notin, zotëri...
FILIPI — Nuk notohet në një det me furtunë,
Gaspër.

NOTERI — Kam se ku të kapem, mos u bëj
merak.

FILIPI — Nipin?
NOTERI — Ndosh...
FILIPI — Bëj ç'të duash. Unë kam nevojë për
Zyberin.

NOTERI — Zotëri, ruaju edhe prej gjermanëve.

FILIPI — Dreq o punë, u futa në mes të dy zjarrreve.

NOTERI — Thuhet, zotëri i dashur, se ti e ken dihmuar atë Tomën, për t'i nxjerrë nga burgu ata tre komunistët, sepse të paskan dhënë 1000 napolona ar.

FILIPI — Rrena, rrena me bisht! E di, ai togeri ma punoi këtë rreng. Po do të më njohë kush jam unë. (*çohet në këmbë*) Nejse, Gaspér, të lutem vrapo tek ai. Unë tek ti e kam mbështetur shpëtimin, meqë evlatin e kam si e di...

NOTERI — Shkova.

FILIPI — Dole keq, pa një kafe (*e përcjell deri te dera*)

NOTERI — Vera është më e mirë se kafja. (*del. Filipi e myll derën e niset nga shtëpia; befas thërret*) O Ndoc, Ndoc!

Vjen Ndoci e Liza duke mbartur një damixhan.

NDOCI — (*Lizës*) Ule, bijë. (*i afrohet Filipit*) Ur-dhëro, zotëri.

FILIPI — Rri roje këtu. Askërkënd mës lejotë hyjë brenda pa lejën time. As atë togerin, as edhe gjermanët.

NDOCI — As gjermanët?!

FILIPI — Askënd, merr vesh?

NDOCI — Roje pa pushkë, sikur nuk shkon, zotëri.

FILIPI — Merr një hu. Hap sytë! (*nga shtëpia*) Freda, ku je, bijë?

FREDA — Këtu, në sallon, babi.

FILIPI — Po vij. (futet në shtëpi. Ndoci ka marrë një hu).

LIZA — Ç'po bën?

NDOCI — Ssst, jam roje, e rojet nuk flasin.

LIZA — Roje! Ku shkuan xhandarët?

NDOCI — Këtu diçka po luan.

LIZA — Të mjerët ne, bukën e kujt hamë!

NDOCI — Do të vijë dita jonë, shpejt, më tha Toma!

LIZA — E pe ndokund?

NDOCI — Ehe, e përcolla dhe i urova punë të mbarë...

Vijnë Gjoni dhe Tefa krah për krah. Duken të gjëzuar.

GJONI — Parashikimi im do të realizohet pikë për pikë. Nesër do të jem zot këtu.

TEFA — Pse, ndërrrove mendim?

GJONI — Kurrë. Pasnesër, adio, Albania! (*hedh shishen te këmbët e Ndocit*) Ndoc, shko e mbushe këtë shishe. Lizë, ec këtu. Diçka dua të kem ndër duar unë, o shishen, o Lizën. (*do ta kap*)

NDOCI — (i futet në mes) Ngadalë beg, se ka hendek.

GJONI — Ta tregoj hendekun me këtë grusht.

NDOCI — Pse, unë i kam duart të lidhura? (i afrohet kërcënues) Lizën mos e prek, more vesh?

LIZA — Mos u zini.

NDOCI — T'i thyej turinjtë.

GJONI — Harbut!

Kapen. Ndoci e përfshin për beli dhe e rrëzon.

TEFA — (qesh) Oh, bum përtokë, vetëtimthi.

GJONI — (çohet, i afrohet Ndocit) Toke! (*i shtrin dorën*)

NDOCI — Do prapë?

GJONI — Bëhemë miq?

NDOCI — Rrimë kështu si jemi më mirë.

GJONI — Toke!

NDOCI — Mirë (*i jep dorën*)

GJONI — (*e përqafon*) Dua të bëhem probatin me ty.

NDOCI — Ta përziej gjakun me ty?!

TEFA — Ke frikë?

NDOCI — Fëlliqësira...

TEFA — Mbaje gojën!

NDOCI — Do edhe ti?

TEFA — Ah, jo... (*Gjonit*) Atje jam. (*shkon në shtëpi*.)

LIZA — Edhe unë kam punë, Ndoc. (*del*)

GJONI — Ndoc!

NDOCI — E?

GJONI — Ti je më i mendskëm në këtë shtëpi.

NDOCI — Kam mend sa për vete, zotëri.

GJONI — Kam besim të ti, prandaj due të të hap zemrën.

NDOCI — Mos i jep çelës, se nuk kam mall ta shoh.

ZËRI I FILIPIT — Ndooc!

GJONI — Qenka tërbuar fare (*fshihet*)

NDOCI — Urdhëro, zotëri.

FILIPI — Ku je, more qen?

NDOCI — Te dera e oborrit ku më le ti vetë, zotëri.

Duket Filip Babuna i veshur me rrobat e majoret. Ka në dorë një pergamen të bërë gyp.

FILIPI — Ka plasur një bela e madhe... Ndoc djali.

NDOCI — Bela e madhe?

FILIPI — Ehe. Këta të mbytin në gjumë. E për ç'farë e mprehu shpatën ai katili, thua ti?

NDOCI — Ku di unë.

FILIPI — Po iki. Mirëpo nuk dua ta marrë vesh askush. Këtyre thuaju që dola për një punë.

NDOCI — Mirë.

FILIPI — Nuk ka rrugë tjetër: o puth kryqin o kërce hendekun. Dëgjo, Ndoc, po erdhi Gaspri me Zyber aganë, nuk e njeh ti këtë Zyber aganë, por po erdhi Gaspri me një tjetër, m'i ço atje te Lajdja, se atje kam vendosur të fshihem. Jam i sigurt dhe i qetë atje. Dëgjo, çelësat e kantinës mos ja jep njeriu, more vesh?

NDOCI — Mora, mora.

FILIPI — Jam hutuar fare; harrova ta grisja këtë testament.

NDOCI — Ta `grisësh?

FILIPI — Dhe ata mbeten me gisht në gojë.

NDOCI — Mos zotëri, mos, për hatër të pleshtit të djegësh jorganin!

FILIPI — Ta hanë qentë pasurinë time, e ata të mos kenë as edhe një kockë për të lëpirë.

NDOCI — Mendo, zotëri, se kur e bëre, nuk qe punë e kollajtë, m'u desh të rrija gati dhe të të njomja buzët, sa herë nxirrje një fjalë. Ti këtë punë mund ta bësh kurdo, madje, po nuk munde ti, e bëjmë ne: na thuaj, griseni, e ne e grisim në çast.

FILIPI — (*mbetet në mendim*) Duhet ta fsheh.

NDOCI — Ma jep mua...

FILIPI — Jo. (*futet përsëri në shtëpi*)

Del Gjoni

GJONI — Hë, ç'tha?

NDOCI — Nuk mora vesh asgjë. Foli sikur të
ishte tabë.

GJONI — Po vjen (*fshihet ku ishte*)

Vjen Filipi.

FILIPI — E fsheha në një vend, që as dreqi nuk mund ta gjejë. (*në mirëbesim*) Po i përzë prej shtëpie, por një mbetet këtu: Freda. Kush më siguron që nuk i mbushet mendja një ditë të më hedhë helm në gjellë? Ju ka kërcyer në kokë, që të më mytin. Këtu vdekja më ndjek si hije. Te zonja Lajde po, jam i sigurtë... Dëgjo, për çdo ditë në mëngjez eja atje e më jep raport. Çelësat, as njeriut të gjallë!

NDOCI — Fli, në një krah, zotëri.

FILIPI — Mos më vidh, Ndoc! Hajt, natën e mirë! (*i jep dorën*) Mos qaj, mos qaj, bre, se do të shihemi prapë.

NDOCI — Diçka më hyri në sy, zotëri.

FILIPI — E fsheh si burrat shkakun. Të lumtë ja, për këtë më pëlqen ti. Çelësat... Uh, harrova, tash-ti shko e shtriu ti në shtratin tim. Të kujtojnë se jam unë aty... Ssst!

NDOCI — Kam jatakun tim në kaçorren time unë.

FILIPI — Sonte fli këtu, dua që të flesh këtu: Të dua fort, more Ndoc djali. Kur e dua një njeri, nuk e llogarit kush është ai. Dikush po vjen. Shkova. (*sillet nga shtëpia e luan grushtin*). Hë, përbind-sha! Do t'ua shtyp kokën. Natën e mirë. Edhe dëgjo, mos rri duke menduar hallin tim, çudi e madhe! Të

paça! (e përqafon) Eh, si më çohet zemra peshë, mure Ndoc: po e le shtëpinë në dorën tënde. Më përcill pak... apo, ktheu, ktheu!

NDOCI — Si të duash.

FILIPI — Po dal vetëm. Revolen... Ah, e lashë... Jo, e paskam në këllëf. Dorën në të e bafti i zotit. Mos qaj, bre Ndoc!

NDOCI — Qaj vetëm me syrin e majtë, zotëri.

FILIPI — Më syrin e zemrës. Qëndro si burrat e mos ndill zi! Roje!

NDOCI — Harrove se roje më vurë mua, zotëri?

FILIPI — Oh, oh, oh! Puna ngatërrohet edhe më shumë tani. Vetëm... Pa një roje që të më hapë rrugë! Më mirë të vishesha civil.

NDOCI — Mos u pendo, zotëri. Natë është e nuk të njeh njeri. Pastaj, zonja Lajde nuk e ka shtëpinë larg.

FILIPI — Mirë thua, Bafti i zotit! (del)

del Gjoni.

GJONI — Urraaa, urraaa, urraaa!

NDOCI — Ç'pate, zotëri?

GJONI — Fitore! Shtëpia u bë imja, ashtu si e pata parashikuar.

NDOCI — Shtëpia pa çelës, është si kuleta pa pare.

Vijnë Tefa dhe Freda.

GJONI — Tefë! Fredë!

NDOCI — Mos u ngut, zotëri; ai shkoi, por këtë lënë zëvendësin këtu.

GJONI — Kur bëhet grusht shteti, nuk ka zë-vendës të qeverisë së rrëzuar.

NDOCI — Nuk di punë qeverish, po zëvendësi këtu jam unë.

GJONI — Je ti?

NDOCI — Mblidhëni mendjen: po nuk ju dhashë unë për të ngrënë, ju ngordhni si minjtë?

FREDA — Hë, çfarë ka ndodhur?

TEFA — Nuk po marrim vesh asgjë.

GJONI — Plaku iku. Zot shtëpie jam unë.

NDOCI — Bëj petulla në ujë, bëj.

GJONI — Jemi të lirë të bëjmë ç'të duam.

Dëgjohen të shtëna pushkësh. Liza duket në prak.

LIZA — Ndoc, ec brenda.

NDOCI — Nuk më ndodh gjë mua, bijë, nuk më ndodh.

LIZA — Kësaj shtëpie i ka hyrë zjarri...

GJONI — Mbylle derën.

NDOCI — Mbylle vetë.

TEFA — (Fredës) Freda, shko, e mbylle.

FREDA — Oj, i mendshëm.

LIZA — Po e mbyll vetë.

Atë çast, hyn një djalosh me automatik në dorë. Është i veshur si xhandar. Kur është afër, e njohin të gjithë. Freda nxjerr një klithmë e bie ndër kra-hët e Gjonit.

FREDA — Toma!

GJONI — Ai vetë.

TEFA — Mos e sill automatikun nga unë, Tomë.
TOMA — Ssst! Po më ndjekin. Do të fshihem këtu tek ju. Po të më paditë ndonjeri, ja qep petkun e vdekjes me plumba.

NDOCI — Ec pas meje.

LIZA — Çfarë ndodhi?

TOMA — Edhe qarkomandantin e ri e hodhëm me këmbë përpjetë. Por kur po vija këtu se mora vesh që rojet ja hoqën majorit trim e të mendshëm, si thoshte ai tetari, — pra, kur po vija këtu, ndesha në një oficer që qëlloi. Po unë qesh më i shpejtë.

LIZA — E vrate?

TOMA — Ku di unë?

NDOCI — Bisedën bëjeni brenda. (*Ndoci, Toma, Liza futen në shtëpi*)

FREDA — Sa e tmerrshme! Toma...

TEFA — Mbaje veten, motër.

FREDA — Nuk e dëgjove ç'tha? Ja qep petkun e vdekjes me plumba!

TEFA — Ti po e sheh, se asnjeri nuk po rrëzohet.

GJONI — Të futemi në shtëpi, se këtu... Diskush po vrapon. Ejani!

Hyn oficeri me një xhandar.

OFICERI — Mos u shqetësoni, zotërinj. Po ndjekim një komunist.

GJONI — Komunisti në shtëpi tonë nuk ka ç'bën.

OFICERI — Erdha... Mbajeni veten, ju lutem... Zotëri majori... babai i juaj është në shtëpi?

FREDA — Jo, paska dalë.

OFICERI — Nuk di nga t'ia filloj... Zotërinj, jam i detyruar t'ju jap një lajm të hidhur.

TEFA — Qite të shkretën.

OFICERI — Ja... Qëndroni, ju lutem, s'kam ç'bëj: baba juaj, zotëri major Filip Babuna, ish qar-komandanti, u vra...

FREDA — T'u thaftë goja! (*qan*)

OFICERI — Kështu e ka puna jonë, zonjushe. Sot ai, nesër unë. Më sa shoh, nuk do të mbetemi asnjë. Më falni, ju lutem, që ua solla këtë lajm të pikëlluar, por dikush do ta sillte. Natën e mirë. (*Dalin.*)

GJONI — Fundi!

TEFA — Jo, mos u ngut... Ndoshta është fillimi.

Perdja

— Dëshirat e mësuarit — IZOLI
— Dëshirat e mësuarit — AHT
— Dëshirat e mësuarit — IZOLI
— Dëshirat e mësuarit — AHT
— Dëshirat e mësuarit — IZOLI
— Dëshirat e mësuarit — AHT
— Dëshirat e mësuarit — IZOLI
— Dëshirat e mësuarit — AHT
— Dëshirat e mësuarit — IZOLI
— Dëshirat e mësuarit — AHT
— Dëshirat e mësuarit — IZOLI
— Dëshirat e mësuarit — AHT

— Dëshirat e mësuarit — IZOLI
— Dëshirat e mësuarit — AHT
— Dëshirat e mësuarit — IZOLI
— Dëshirat e mësuarit — AHT
— Dëshirat e mësuarit — IZOLI
— Dëshirat e mësuarit — AHT

AKTI I KATERT

Salon. Natë. Herë pas here dëgjohen pushkë, batare, topa. Afër pikturës së gjyshit, është varur edhe fotografia e major Filip Babunës, rrethuar me kordë të zezë. Freda, e veshur për zi, luan diçka funebre. Duket shumë e pikëlluar.

Në mes është shtruar një tryezë me pjata, pirunj, thika, gota, peceta etj.

Tefa është shtrirë në dysheme dhe zgjat duart diçka kërkon nën poltronë.

Gjoni zurret shkallët, ka në dorë një çekiç dhe një daltë, duket i lodhur.

GJONI — (*turfullon*) Djalli e marrtë!

TEFA — (*cohet*) Mos u anko e marrtë e mira, se nuk shkon sot në ditë zije.

GJONI — As Polifemi nuk e hap dot!

TEFA — Do ta hapim, do ta hapim, durim.

GJONI — Durim? Nuk dëgjon ç'bëhet jashtë. Pëna shket toka nën këmbë. Nesër niset motobarka e ne nuk kemi asnje lek në xhep.

TEFA — Fundi i vëmë dinamitin kasafortës. Bën pak zhurmë, por nuk shqetëson njeri në një natë si kjo.

GJONI — Ku ta marrim?

TEFA — Ku?

GJONI — Ë. ë. ku?

TEFA — Eh, ma more shpirtin me këto pyetje. E blejmë në dyqan.

GJONI — Ti je i fjetur, more bukurosh. Nuk e di se prej tri ditësh dyqanet janë të mbyllura?

Freda lë pianon dhe afrohet.

FREDA — Asgjë?

GJONI — Dihet. Plaku ishte dinak.

FREDA — Dëgjoni, djem, ka një javë, që tata... ndjesë pastë... (*i dridhet zëri nga mallëngjimi*) ka fshehur diçka në kopsht. E kam parë unë, kur është ngritur një ditë-herët... pa zbardhur drita. Kishte ndër duar një arkë të vogël hekuri.

TEFA — Paret! Verdhushkat...

GJONI — O burra, pas meje!

FREDA — (*ua zën rrugën*) Jo, nuk ju lë. Pa gjetur testamentin, nuk ju lë ta prekni.

TEFA — Për Krisht, do t'i ndajmë në mënyrë të barabartë (*e merr me të mirë*) Marroqe, po pse krundet, aty ka plot për të tre.

FREDA — Nuk ju besoj.

GJONI — Hajt, shpejt, na ço atje!

FREDA — Jo.

GJONI — Freda!

TEFA — Freda!

FREDA — Mos bërtitni, se nuk më frigoni.

TEFA — Mirë, merri ti. (*Gjonit*) Ja japim kësaj t'i ndajë, ë, Gjon?

GJONI — Nuk kam ndonjë kundërshtim.

TEFA — (*e rrok për beli me shumë përzemërsi*) Ne të kemi motër, budallaqe. Hë, a hiqet thoi nga gishti? Pse, njëqind motra kemi ne? Një. Vetëm një.

Njeriu, kur s'ka, bëhet i egër, po, kur ka, bëhet bujar. Ec.

FREDA — (*pasi mendon pak*) Mirë... (*Dalin*)

Vjen Liza nga kuzhina me një kanistër me bukë. E vendos në tryezë. Nga dera tjetër del Ndoci me një damixhan me verë.

LIZA — Solle edhe verë?

NDOCI — Po, he, ua piftë dreqi në bark! Ku ta lë?

LIZA — Çoje në kuzhinë, se po ta lë këtu, ma përpinë...

NDOCI — (*dëgjon*) Tërë ditën nuk pushuan pushkët një herë.

LIZA — Ju erdhi fundi këtyre lugëtëve.

NDOCI — Ç'të mbjellësh korr! (*hyn në kuzhinë dhe pas pak del*) Hej moj botë, hej! Këta i hanë sonte darkën major Filip: Babunës, kurse ai vetë ha darkë me Lajden.

LIZA — Gjallë!

NDOCI — Është plagosur pak në krah e vetëm krahun ka lidhur dhe mezi e lëviz, kurse gojën e këmbët i ka si përpara.

LIZA — Atëhere pse u hap fjala se vdiq dhe u varros në Tiranë?

NDOCI — Zoti Gaspri u pagua mirë që ta hapte atë lajm të tillë.

LIZA — Po telegramin këtyre kush ua çoi?

NDOCI — Ai vetë.

LIZA — Zotëria?

NDOCI — Më tha: «Eh, more Ndoc djali, po fshihem pas vdekjes, për të shpëtuar nga komunistët dhe nga ata përbindshit që kam në shtëpi». Nuk e di

zoti Filip se, përveç këtyre të cilëve u intereson vdekja e tij, askush tjetër nuk beson, se unë njoftova edhe Tomën si qëndron puna.

LIZA — Unë kujtova se ngordhi.

NDOCI — Mos u mërzit se do të ngordhë shumë shpejt...

LIZA — Duhet të jetë dobësuar?

NDOCI — Sa herë kam shkuar, e kam gjetur duke ngrënë.

LIZA — Oh, Ndoc, the se je takuar me Tomën, Hë?

NDOCI — Me të e me gjithë partizanët. Ishte ai komisari. «Shoku Ndoc këtu, shoku Ndoc atje», sikur kush e di se kush isha unë.

LIZA — Si nuk pate frikë të kaloje matanë?

NDOCI — Detyra...

LIZA — Çfarë detyre?

NDOCI — Mos prit përgjegje për çdo pyetje që bën, shoqja Lizzë.

LIZA — Nuk më beson?

NDOCI — E ke gabim shoqja Lizzë! Mos më shty të bëj gabim që të bind se të besoj me kokë.

Kthehen Freda, Gjoni, Tefa.

FREDA — Edhe po të më mbytni, nuk më kujtohet vendi.

TEFA — Ta mihim kopshtin.

GJONI — Mos fol marrëzira!

TEFA — Punëtorët, jo ne.

GJONI — Ku t'i marrësh?

TEFA — Prapë ky «ku»?

GJONI — Punëtorët kanë kapur pushkën e luftojnë. Po t'i paguash edhe me flori, nuk prekin kaz-

më me dorë tani. Dëgjon? Ti e ke kokën mbi re, mor bukurosh. (*Freda ulet në piano, Gjoni i afrohet*) Mos na gënjeve, moj?

FREDA — E kam parë me këta dy sy, m'u qorrashin.

GJONI — Unë them se nuk na e tregove vendin me dashje.

FREDA — Ndoshta kam harruar. Ndoshta... mendje është kjo.

TEFA — Gënjeshtra i ka këmbët e shkurtëra.

GJONI — Kemi edhe një shpresë. Ec me mua, Tefë. (*Ngjiten lart*)

Te hyrja e salonit duket noteri.

LIZA — Erdhi ky korbi.

NOTERI — Mirëmbrëma!

LIZA — Mirë se vjen.

NOTERI — (*ulet në tryezë*) A, e paskeni rregulluar tryezën shumë bukur! Ju lumtë! (*merr një kore bukë dhe përqapet*) Sonte nuk është punë e urtë të dalësh nga strofulla, se po e dëgjoni ç'po bëhet... por shoku Ndoc... shoku Ndoc, kështu duhet ta thërras tani e tutje. Jemi shokë! Shokë! Bukur e kanë sajuar! Pra, shoku Ndoc, tërë ditën mendja më mbeti këtu, se më është dhembsur shumë. Në fund, thashë: «Shko, Gaspër, e haje atë darkë, se nuk ka njeri punë me ty. Partizanët luftojnë kundër gjermanëve dhe ballistëve për çlirimin tonë, domethënë të popullit.» Do të më mbetej peng, po të mos vija, shoku i dashur Ndoc. E para, pse kam qenë mik i atij merhumit, dhe e dyta se kjo është e dyta herë që ha darkë në këtë shtëpi, të parën herë për gradimin (?) e zotëri Filip major.

NDOCI — Nuk po llogarit drekat.

NOTERI — E kemi fjalën për darkat. Dëgjo, Lizië. Oh, më fal, shoqja Lizë! Mos na e vononi bukën. Nuk është natë për ceremoni sonte.

LIZA — Sa të mblidhen edhe të tjerët, zoti Gaspër.

NOTERI — Si the? zotëri! Unë, edhe kur ishte koha e zotnillékut, e kisha bezdi këtë nofkë, shoku Gaspër më thërrisni më mirë, se kështu e ndjej vreten të afërt me ju. Pra, shoqja Lizë, derisa të mblidhen të gjithë, ma mbush një putir raki.

NDOCI — Nuk kemi as një pikë.

NOTERI — Lizë, shoqe... shiko ti, se ky torollaku është koprac i madh, sikur ruan mallin e tet.

LIZA — Ta sjell unë.

NOTERI — Të lumçin këmbët.

NDOCI — Zoti Gaspër, hë, si të duket moti?

NOTERI — Lëre, more atë zotni? E thashë... Për fjalë të nderit që ka shqiptari, zemrohem. Jemi shokë.

NDOCI — Mirë, nuk po të zemroi. Shoku Gaspër, si të duket moti?

NOTERI — Bukur, shumë bukur! Liri! Vijnë partizanët, he, ua marrsha të keqen! Unë këtë ditë kam pritur.

NDOCI — Je me ta?

NOTERI — Kam qenë gjithmonë, more bihude. Kam edhe një nip partizan.

NDOCI — Nipin e ke përzënë nga shtëpia, prej kohe.

NOTERI — S'do mend, nisi t'i dalë era... Nuk doja që ai të shkonte si qeni në vreshtë, se e kam dashur shumë.

NDOCI — E ndërrove pllakën, ë?

NOTERI — S'do mend: mbaron një këngë, fillon tjetra edhe më e bukur.

NDOCI — Do të të vrasë veshin një ditë.

NOTERI — Eh, shoku Ndoc, shumë gjëra nuk pëlqen njeriu në jetë, po... (*Liza i sjell putirin.*) Epo, gëzuar! (*e çon në buzë*) Ah, më falni, harrova... Ju ardhshim në gëzime (*pi*). Ah, raki e ëmbël, e dashur... ta merr me të mirë stomaku, si një ilaç i rrallë. Pak meze, moj Lizë... shoqe, pak meze, nuk pihet kësh-tu thatë.

NDOCI — Tashti do të hamë bukë.

NOTERI — Mos na shit dokrra ti. Hajt vajzë e mirë. (*Liza i sjell diçka në pjatë. Ai i ngul sytë në të*) Ah, kështu po. (*ha*) Po të jap një këshillë, shoku Ndoc: si të bjerë daullja, kërce! Më thoshte babai, ndjesë pastë: «Biro, kur të hysh në aheng, mësoji të gjitha këngët...» Gjeje më hollë ti po të duash. (*qesh*) Jeta është libër, mbaron një fletë fillon tjetrën. Apo jo? (*qesh*) Deri dje, pata mik Filip Babunë, nesër do të kem shokun Ndoc... Si e ke mbiemrin? (*pi*)

NDOCI — Ndoc Kolë Dushku.

NOTERI — Dushk për gogla, si thonë. (*ha meze*) Pra, do të kem mik Ndoc Kolë Dushkun, shërbëtorin e mikut të djeshëm. Po pse? Hë, kështu e ka kjo jallane herë ma hipe, herë ta hipia. Bota është si rrota. Ma mbush edhe një, vajzë e dashur.

LIZA — Vetëm atë pata.

NOTERI — Mos bëj fjalë! Do zoti e të shoh me një burrë të pashëm dhe të mendshëm. Hajt, mbu-she.

LIZA — S'ka, zoti Gaspër.

NOTERI — Shët, zotëri, prapë ti! Dëgjon push-kët? Nuk gëzohesh? Nesër do të bëhesh ti zonjushe

e ajo që rrri atje në piano... (*Freda befas sjell kokën dhe e shikon*) Ah, e mori dreqi qejfin.

FREDA — (*çohet; i turret dhe i bie në gjoks*) Zoti Gaspër... mik i shtrënjtë! (*qan*) Mbetëm pa tattën.

NOTERI — Qëndro, bijë, qëndro! Askush s'ë ka marrë me tapi jetën. Kur vjen vdekja mbarë, nuk është e keqe, por... E dini, në korrik, isha diku i ftuar për darkë, e hangra një çikë shumë... Kushedi ç'më dongëlldisi. Kur ja, vjen doktori e më thotë: «Je helmuar, zoti Gaspér.» Kaq e pata — thashë me vete. Mos ka bërë zoti ndonjë gabim, e po më çon bedel për një tjetër?» (*qesh*). Kështu, bija ime, me radhë, me radhë. Ulu. Këtë meze po e ha nga shoqja Lizë. (*ha*)

FREDA — (*ulet*) Gjithshka më duket e zezë.

NOTERI — Ashtu është; vdekja është natë e përjetshme.

NDOCI — Po lajmëroj zotërinjtë.

NOTERI — Shkoj shumë vonë. (*Ndoci ngjitet lart*) Gatuan mirë Liza, kjo shejtane. Pastaj, babai juaj, zonjushe, e ka mbajtur gjithnjë verën të mirë. Më ankohej: «Pi Gjoni shumë!» Ja pritja: «Ti vetë e ke mësuar, zoti Filip.» Hidhej: «Pse?», i thoshja: «Si pse? Me verë në buzë drekë e darkë, këtë farë vere, që edhe të vdekurit t'iavësh te varri, ngrihet dhe e pi.» Qeshte zotëri Filipi, qeshja edhe unë. Kundërshtonte: «Jo Gaspér, vetëm ndër festa e pimë.» Po unë nuk lëshoja fre? «Po yt bir e di se e ke me fuçi, zotëri Filip... Edhe unë po ta kisha shtëpinë afër, do ta gjeja një vrimë për të hyrë në kantinë.» (*shikon gotat*) Besoj se sonte kemi nga ajo vera e mirë?

LIZA — Nga ajo.

FREDA — Edhe unë nga dëshpërimi, piva pak...

NOTERI — Hë, s'e pike. Miza pse ngel në mjaltë, pse është e marrë? Jo, bijë, por pse mjalti është i ëmbël. Të ngordhë me diçka të ëmbël në gojë si duket, nuk ka knaqësi më të madhe për Mizën.

FREDA — Tata, zoti Gaspër, thoshte... (*nuk mund të flasë prej ngashërimit*)

NOTERI — Lëre të gjorin ku është, mos ja luaj eshtrat — si thonë. Harroje. Kështu kam bërë edhe unë. Vdiq baba. Mirë, thashë: a mund ta kthej prapë në jetë? Jo. (*Çon putirin*) Oh, bosh Lizë, nuk e mbushe, ë?

LIZA — Unë kam një fjalë.

NOTERI — M'u ngjit gjuha pas qiellëzës. (*Fre-dës*) Provoje edhe rakinë ndonjë dite, zonjushe e dashur. (*nxjerr kutinë e duhanit*) Jo, po e lë për pas buke. (*e mbyll prapë dhe e fut në xhep*) Atje ç'ke Lizi?

LIZA — Ëmbëlsirë.

NOTERI — Aq pak për gjithë këta njerëz! Ai Ndoci më koprac se zotëria. Uh, këta nuk po vijnë. O Gjon! Tefë! (*Duchen te shkallët Gjoni dhe Tefa, pas tyre vjen Ndoci*) Ejani, bre djema, ejani, se kam lënë gruan vetëm për të ardhur këtu që t'ju ngushëlloj, si mik i të ndjerit e miku juaj. Pastaj, po na ftohen edhe gjellët. Oh, zotërinj të dashur, është rrezik të më shkrihet gjuha në gojë, tek po shoh të gjithë këto të mira në sofër. Mish gjeldeti...

LIZA — Gjeldeti.

NOTERI — Harrova. (*u jep dorën*) Vetë shëndo-shë djema! Mbahuni. Njeriu sa më shumë halle të ketë, aq më i fortë bëhet. Gjon, Tefë, çojeni kokën e shikoni zotin Gaspër ndër sy. Ashtu. Mos u pikëlloni kaq shumë se merrni veten në qafë. Uluni e hani tanë (*ulet dhe nis e ha*)

GJONI — (*Tefës*) Ulemi.

TEFA — Ik, kam neveri.

NOTERI — (*duke përtypur me uri të madhe*) Eh, zotëri i dashur, ta di hallin, babë nuk të bëhet njeri. Vdekja e tij të hap një plagë të madhe, që tërë jetën të dhemb...

TEFA — Jam keq me bajamet, zoti Gaspër.

NOTERI — Të hamë, fëmijët e mi, të hamë, e të mos flasim: ta çojmë mendjen tek ai që nuk është më këtu në sofër... (*Hanë në heshtje*) Lizë, ma jep atë, ç'është ajo? Këtu, këtu, këtu. Ule!

FREDA — (*pi*) Sa i mirë ishte ai! Iku pa e parë dhe pa e rehatuar me duart tona.

TEFA — Iu lutëm Ndoci që të na jepte pare e të shkonim ta varrosnim, po ky, «jo, nuk kam!»

NDOCI — Në një kohë të tillë, zoti Gaspër, duhet të kesh kohë rezervë. Aeroplanët anglezë nuk po lenë maqinë pasagjerësh të kalojë për në Tiranë.

NOTERI — Ke vepruar me mend. Edhe ju mirë kini bërë që nuk keni shkuan, kurse ata anglezët me ata aeroplanët e tyre duket se më shumë na kanë inat ne shqiptarëve se gjermanët.

GJONI — Dreqi e di ç'bën me paret tona ky.
(*e shikon Ndocrin shtrembër*)

NDOCI — Ato pak pare janë të zotërisë së madh, ju tuajat.

GJONI — Ai vdiq, s'e merr vesh shqipen ti?

NDOCI — Vdiq... Mirë, vdiq, po unë dua të kem një dokument që vdiq.

TEFA — Testamentin.

NDOCI — Së paku.

GJONI — Prandaj është këtu zoti Gaspri.

NOTERI — Më lini të ha, fëmijë të dashur.

FREDA — (*pi*) Tata iku, si të na e rrëmbente njeri... (*qan*)

GJONI — Freda, mos m'i ço nervat përpjetë me ata lot, se kam mjaft halle të tjera.

FREDA — Pusho! (*i bie tavolinës me grusht*)

NOTERI — Ah! Bëhuni më të arësyetueshëm, bijtë e mi. Lërini njerëzit të hanë në qetësi e mos e prishni heshtjen e përmortshme.

GJONI — S'është çudi të më çojnë edhe mua atje para kohe... (*kap kryhet me grushte*)

TEFA — Mëkat! — Këto farë gjellësh janë i dënuar të mos i fut në gojë! Lizë, të lutem, ma ruaj hisen, se mund ta ha më vonë.

NOTERI — (*çohet me solemnitet*) Zotërinj, ndër gëzime u ardhshim. Keni pasur babë të mirë: ngjajini atij. Ty, Lizë, të lumshin të dyja duart. Edhe ty, Ndoc... shoku Ndoc. Mirë, mirë e keni preqatitur. Kjo e nderon edhe atë, që nuk është këtu. E kam fjalën për të zonë e shtëpisë, për zotin Filip. E ai, kudo që të jetë, e bëftë natën e mirë... Oh, gabim! Pushoftë në paqe! Amen! Tani po shkoj, bijtë e mi të dashur, se nuk ka asnjë kuptim të rri më tepër. Atë që erdha të bëj, e bëra, pra natën e mirë.

GJONI — Prit, zoti Gaspër, Nuk lamë vend pa e kërkuar testamentin...

NOTERI — Nuk është, domethënë nuk ka.

FREDA — Si t'ja bëjmë, zoti Gaspër? Pa testament nuk mund të vemë kurkund dorë këtu.

NOTERI — Sigurisht. Po më lini kohë të mendoj.

TEFA — Mendo.

NOTERI — Duhen shikuar ligjet... Oh! Çfarë shpërthimi! Top, top qe ky. Ika.

GJONI — Ti ke thënë se testamentin e ke ti.

NOTERI — Mos më mbani më, zotërinj, se rrëzikohem...

GJONI — Atëhere, kopjen e ke ti.

NOTERI — Nuk ka kopje.

GJONI — Atëhere përbajtjen e di, thuaja kë-tij, Ndoci, e të na i dorëzojë çelësat.

NDOCI — Po nuk e pashë të shkruar dhe të vu-losur mirë e në rregull, nuk ju dorëzoj asgjë.

NOTERI — Ka të drejtë.

GJONI — Dëgjo, zoti Gaspër, shpërblimin ta ja-pim të majmë, veç na nxirr në rrugë.

NOTERI — Fjalët i merr era — karafilit i vjen era. Natën e mirë.

GJONI — Edhe po tallesh? Na sheh kështu të trullosur e tallesh? Turp të kesh! Je edhe plak. Ha bukën e përbrys kupën.

NOTERI — Mos më shty se dal vetë. Zotërinj, natën e mirë! Shoku Ndoci e shoqja Lizë, natën e mi-rë. Po të keni ndonjë gostitje tjetër e nuk më thirrni, ta dini, do të më mbetet hatëri (*tund kokën e buzë-qesh*) Natën e mirë!

GJONI — M'u hiq nga sytë, se po të merr dreqi.

NOTERI — Oh, jo, zotëri, jo. Dëgjon? Tak, tak, pam, pam, bum, bum! Lufta! Unë nuk trembem, e shikon? Kështu që as prej teje nuk kam frikë. Njeriu në luftë bëhet i guximshëm.

NDOCI — Jo lufta, zoti Gaspër, po vera.

NOTERI — Vera — rrëna. (*qesh e del*)

GJONI — Hajt, mos mbërrifsh shëndosh në shtëpi. (*sillet me duar prapa. Ndoci e Liza marrin pjat e gjërat, që janë në tryezë dhe shkojnë në kuzhinë*). Jam mërzitur! Jam mër-zi-tur! Po çmendem!

TEFA — Pse unë, jo? Mbaje veten, vlla.

FREDA — (*kap gotën*) Pse nuk pi? (*qesh*) Rrof-të vera!

GJONI — Po helm ka ndokund?

FREDA — E le ti, e nisa unë (*këndon*)

Vieni, çe una strada nel bosko.

Il suo nome konosko

Vuoi konosherlo tu? (*qesh*)

GJONI — Freda, mjافت!

FREDA — Oh! (*qesh*)

TEFA — Je dehur, motér.

FREDA — Dua të harroj... dua të harroj gjithshka... madje edhe se jam gjallë... unë, Freda Babuna, që dikur lulëzova ndër sytë e të tjerëve, kursetani jam vyshkur, jam bërë kufomë e gjallë... Kufomë! Kufomë, ja ç'jam unë... (*ulet në piano, qan. Heshtje.*)

GJONI — (*Tefës*) Po sikur të shikojmë njëherë në kantinë?

TEFA — Kush t'i jep çelësat se?

GJONI — Ndoci. Fol ti me të. O Ndoc, Ndoc!

NDOCI — (*del nga kuzhina duke u përcapur*) I ka rënë njeriut të fikët, që më çuat nga buka?

TEFA — Dëgjo, Ndoc! Na shkoi mendja se babai ynë, i ndjeri, mund ta ketë fshehur testamentin në kantinë.

NDOCI — Po të mos e dija se je esëll, do të thosha: po flet pija, jo zotëria.

GJONI — Aty, aty, mund të jetë.

NDOCI — Ejani e hiqeni edhe atë merak. (*u prin. Dalin. Heshtje.*)

FREDA — (*befas ngrihet dhe heq valle*) Tralala-tralala! Oh, Andrea, Andrea, ku je? Pse më braktise, mizor? Jo, ai tanimë nuk ekziston... Ëndrra, ëndrra, ëndrra... Ja, kjo qejeta ime... Pse, ti ekziston, ma-

rroqe? (*qesh. Me afsh.*) O zot! Kam nevojë të kem pranë dikë... Ende nuk jam plakë... Dua dikë... zot! Tralala-tralala! Po vyshkem si ajo lulja pa ujë... Pi, pi, pi! (*çon gotën*) Pije, për inat të fatit koprac, pije edhe për inat të dreqt... edhe... edhe... po, edhe për inat të zotit, që më dha një fat të tillë... Ah, jo, jo, Freda: kalova larg... larg! (*bie në gjumë*) Më fal, o Zot! Fale këtë mëkatare! Ti je i mirë. Ho, sa fatkeqe jam! (*qan*) Po, fatkeqe... fatkeqe... fatkeqe!

Kthehet Ndoci. Ajo e vëren për pak, ngrihet ngadalë. Ja ka ngulur sytë, e kap për krahut.

FREDA — Ah, Ndoci, Ndoci!

NDOCI — Ç'po më merr erë si konkë?

FREDA — Të vjen era e mirë...

NDOCI — Mua? Hehe!

FREDA — Ty: ha! Erë mashkulli...

NDOCI — S'ka ç'të më vijë tjetër.

FREDA — Ndoci! (*e puth me afsh*)

NDOCI — (*e shtyn*) Më zure frymën, dreq!

FREDA — (*bërtet*) Jam fatkeqe... (*ulet në piano e luan diçka*)

NDOCI — Fatkeqe, po, si urdhëron, pi verë në vend të ujit e bërtet: «Jam fatkeqe!» Mos më bëri me të kuq buzësh kjo marroqe, se po të më shohë gruaja, më rruajti mustaqet. (*shikohet në pasqyrë dhe fshihet*) Iku. (*Kur kalon nga pianoja, merr anën, përt'iu shmangur rrezikut të një përqafimi të dytë. Futtet në kuzhinë.*)

Vijnë Gjoni dhe Tefa.

TEFA — Pas gjithë kësaj bredhjeje, më erdhi uria. (*Freda nis këndon.*)

GJONI — Pusho ti, laraskë e çmendur!

FREDA — Oh, sa më frikësove, shpirtkazmë!

GJONI — Mbylle! (*e kërcënnon*)

FREDA — Bjer, bjer, në ta mban!

GJONI — Ku linda në një çerdhe me ty, kuku-vajkë!

FREDA — Ujk!

TEFA — Mos u zeni sonte se...

GJONI — Po të isha ujk, do t'ju copëloja!

TEFA — Oj, oj, edhe me mua e ka ky!

GJONI — Edhe me ty. Pse je gjallë ti?

TEFA — Pse? Jam.

GJONI — Që të ruash angjinat të mos të ftohen. E ti?

TEFA — Nuk dua të flas më ty.

GJONI — Kurse ti je një kukuvajkë, që di vetëm të qash.

FREDA — Po ti kush je?

GJONI — Unë? Unë linda kot këtu e kot jam gjallë... Ky është një gabim i madh... Jo, dy gabime. Mos qeshni! Gabime, po. Pse nuk linda në Itali ose në Francë, ose kudo që të mos ishte Shqipëri, pse? E, pra, që ta dini, unë rroj që të pi e, duke pirë, të harroj se ekziston ky gabim i madh, që quhet Gjon Babuna.

TEFA — Ah, unë kujtoja se e piye verën se ta kishte ënda.

FREDA — Filozofon, djali...

TEFA — Unë nuk di shumë gjëra, vlla, por për një gjë jam i sigurt: në jetë, ai që nuk e prish gjakun, fiton. Aristoteli nuk ka qenë i marrë kur thoshte se... Eh, ti nuk ua vë veshin fjalëve të mia. Më mirë po shkoj e ha, se po më kokorisin zorrët.

GJONI — (*e kap. Me sy nga koburja*) Kam frikë, Tefë, mos më lë vetëm. Ja, më duket se vdekja, doli prej këtu, e po më merr prapa. E shoh këtu, afër meje. Ja, ecën në majë të gishtave. Qesh me mua. Largoju, largoju e mallkuar.

FREDA — (*Me përcëmim*) Teatër, teatër, teatër! (*ngjitet lart*)

TEFA — Nervat, vlla, nervat...

GJONI — Koburja...

TEFA — E gjyshit tonë të nderuar.

GJONI — Diçka parandjej... (*bie në poltronë e e fsheh fytyrën me pëllëmbë*)

TEFA — Koburja është një armë që të hap biren sa një rrotë qerreje. Jo, disi më të vogël. Plaku thoshte, se vdekjen e ka pasur më të ëmbël se këto pushkët e sotme. Vdekje... Oh, unë rri e llomotis e harroj se zorrët më kanë lajmëruar prej kohe përkryengritje. (*shkon në guzhinë*)

GJONI — (*ngrihet, duket i vendosur për diçka, merr koburen, e çon vetëtimthi, e mban ashtu për pak, e ul*) Nuk ma mban, djalli e marrtë! Kam në gjoks zemër lepuri. Hapt guxim, shuaje këtë bishtuk, që nxjerr vetëm tym. (*e ngre përsëri ku e kishte. Dora i dridhet. Vëren me bisht të syrit grykën e kobures. Befas e largon nga ai pozicion dhe e ul afër syve*) Ç'është kjo letër këtu? (*e nxjerr letrën, e hap nga-dalë, pastaj bërtet me sa fuqi ka*) E gjeta, e gjeta, e gjeta!

Del Tefa. Ulet edhe Freda me robdeshamber.

TEFA — Ç'ka gjete?

GJONI — Testamentin. Ja! (*e tund në ajër*) Testamenti! (*e puth;*

TEFA — Të lumtë!

FREDA — Ta lexojmë. Tata me atë testament na i ndan davatë.

GJONI — (*lexon*) Unë major Filip Babuna... (*Freda hidhet dhe ja gris një copë*) Ç'bëre, moj, të luajti çekerku?

TEFA — (*duke këptuar qëllimin e së motrës, heq edhe ai një copë*) Mos e prish gjakun, Gjon, edhe testamenti duhet ndarë në tri pjesë.

FREDA — Kështu nuk mund të xhvatim njëri-tjetrin.

GJONI — Ju marrtë djalli, e prishtë testamentin.

TEFA — E pse? Bashkohen menjëherë tri copat, po qe nevoja.

FREDA — Po të biem në ujdi.

TEFA — Të shkojmë të noteri.

GJONI — Nuk vlen asgjë...

FREDA — E dëgjon, Tefë, ç'bëhet jashtë? Nessë. Ditë e re nafakë e re. Tralala, tralala!

GJONI — Nepërkkë!

FREDA — Ujk.

TEFA — Gëzohuni tani, qeshni, këndoni, vallëzoni... Uh, mirë m'u kujtua. Pse nuk ja marrim Ndotic çelësat?

FREDA — Ja marrim. Pimë.

TEFA — Përjashta, le të kërcasë e të bubullojë, duhet ta lagim.

FREDA — Thirre.

TEFA — Thirre ti.

GJONI — (*bashkohet befas me ta*) Ti je gjakftohtë, Tefë, dhe e bind.

TEFA — Gjakftohtë? Aty është e keqja ime. Ti

ndizesh e fikesh si kashta, po unë? Barut jam kur nxehem. Nuk pyes kë kam përpara. Po, jo nuk ka rrezik të shkojë p'una gjer aty. Ne kemi testamentin, e ai duhet të na i japë çelësat. Ndoc!

Del Ndoci.

NDOCI — Ç'dreq ju ka rënë ndër mend tanë?

GJONI — Çelësat këtu! (*shtrin dorën*)

TEFA — Kemi testamentin. (*Tregojnë copat*)

FREDA — Nuk ka urdhër më të fortë se ky.

GJONI — As fjala e atij merhumit nuk do të ishte kaq e fortë.

TEFA — Çelësat këtu!

NDOCI — Kurrë!

FREDA — Kusar.

NDOCI — (*çon dorën në brez.*) Mos u afroni!

TEFA — Ka revole!

FREDA — Ta mësyjmë të tre së bashku.

GJONI — Kujdes. Tefë, andej ti...

NDOCI — (*e ka nxjerrë revolen*) Mos luani se ju lashë top në vend.

Hapet dera. Hyn një zonjë e madhe, e shëndo-shë, me një kapele jashtë mode. Të gjithë ja ngulin sytë.

FREDA — Ç'doni në këtë orë, zonjë?

TEFA — Nuk ju njo him.

GJONI — Kush jeni?

ZONJA — Gomarë! Ju nuk jetoni në këtë botë, nuk dini ç'bëhet rrëth jush. U përmbyss, kuptoni? E mori dreqi, u ngatërrua lëmshi, çudi e madhe, e nuk ka zot, që ja gjen fillin kësaj pune. Partizanët morën gjysmën e qytetit, iu afroan shtëpisë së zonjës Lajde.

FREDA — Babi!

GJONI — Gjallë!

TEFA — Gjallë!

FREDA — (e *turbulluar*) Jo, është fantazma e tij.

FILIPI — Jam dora vetë, ju plaçin sytë! Baba: Filip Babunja.

GJONI — Të të prek pak.

FILIPI — Mos u afro! (*nxjerr revolen*) He, ç'je ti: skile! Po të kisha ndenjur këtu më ishte harruar emri prej kohe. Përbindsh, ja ç'je ti, përbindsh. (*Ndotit lehtë*) Më përcill deri në kopsht. Merr një lopatë. (*Dalin*)

TEFA — Gjallë.

GJONI — Gjithshka u përbys.

FREDA — (*shikon copën e testamentit*) Kjo nuk vlen më (e *hedh*)

TEFA — As kjo (e *hedh*).

GJONI — As kjo (edhe ai e *hedh*) Eh, adio Italia!

Heshtje.

FREDA — Endërr më duket...

TEFA — Mua zhgjendër e keqe.

GJONI — (i *përmalluar*) Testamenti...

TEFA — Pse të mos e detyrojmë të na japë parret? Tani e kemi në dorë.

GJONI — Ejani pas meje...

Vjen Filipi e pas tij Ndoci me një arkë ndër duar.

FILIPI — He, ç'rrini si hunj gardhi, çudi e mадhe?! Luani! Freda, merr kapotën edhe një shall, se ёshtë ftohtë. Ti, Tefë, kape arkën. (*Freda ngjitet*)

GJONI — E marr unë, babë (*sulet ta kapë*)

FILIPI — (*ja heq duart dhe e shtyn*) Jo. Ti do të rrish këtu.

GJONI — Falmë, babë. (*bie ndër gjunj*). Të puth këmbët.

FILIPI — Çohu, kërmë; nuk të fal.

GJONI — Babë!

FILIPI — Shët, nuk jam baba yt.

GJONI — Mos më lërë, do të më vrasin ata...

FILIPI — Atë ke kërkuar.

FREDA — (*vjen e veshur*) Kur do të shkojmë, babi?

FILIPI — Ku tjetër veç se në Itali? Lërini fjalët e shpejtoni, se na pret zonja Lajde në krye të rrugës. E lashë roje të gjorën. Ndoc, ti po rri. Mirë. Hapt, toke! (*e përqafon*) Shtëpinë po ta lë në dorë. Do të të shkruaj letër, si e tek të veprosh. Tani nuk kam ç'të them tjetër, se e kam kokën tym. Shkojmë. (*Dalin. Pas tyre shkon edhe Gjoni*)

Perdja.

Tablo e dytë

Natë. Nëpër errësirë vezullojnë drita të largëta. Aty afér llapashiten valët e detit. Dalin në breg Filipi, Lajdja që e mban për krahu, — Freda, Tefa dhe Gjoni.

LAJDJA — Ulu e pusho pak, Lipi!

FILIPI — E marrtë dreqi barkën, m'i bëri zorrët lëmsh. Më merren mendtë ende, zonja Lajde. Me vjen për të vjellë, por nuk nxjerr dot gjë, se e kam stomakun e fortë.

GJONI — Urраа!..

TEFA — Urra — urra!

FILIPI — Ssst! Budallenj, se edhe në Itali ka komunista.

FREDA — Pse, Italia është kjo, tatë?

FILIPI — Dora vetë.

LAJDJA — Edhe pse nuk kam qenë ndonjë herë, nuk po më duket Itali ky breg.

FREDA — Nuk po dëgjojmë asnjë serenatë.

FILIPI — Budallaqe. Hala te ura ti. Kujt i bie ndër mend të këndojë, në këtë tufan që e ka përzier botën dhe e ka mbushur me tym? Dale pak, të marrim frymë lirisht. Liri! Për këtë ka nevojë shpirti im. Lajde, mbështillu zemra ime, nuk e ndjen se fryn?

Ashtu. Të mos marrim ndonjë plevit tani që shpë-tuam. E për sa i përket kësaj toke, kjo është Italia sepse s'mund të jetë tjetër, pra mos harroni se e ka shkretuar lufta të gjorën tokë. Është bërë goxha luf-të këtu. Po, sidoqoftë, unë s'ju a heq të drejtën të pyesni: në ç'qytet jemi? A, për këtë e kam të vësh-tirë t'ju përgjigjem. Por, me siguri, diku afër Barit e Brindisit.

LAJDJA — Çou Lipi, e të ecim nga pak.

FILIPI — Nuk mundem. Këmbët më rëndoijnë si plumb. Po, pse të ngutemi? Të presim ndonjë taksi.

FREDA — Nuk më rrihet këtu. Mbështetu përmua, tatë. Ecim dhe pushojmë.

FILIPI — Mirë. (*Bëjnë disa hapa.*) Pritni, mos keni harruar gjë?

TEFA — Unë i kam të gjitha.

FREDA — Edhe unë.

FILIPI — Po arkën kush e ka, more krye-shkëmb?

TEFA — Mjaft e mbarta unë, babë.

FREDA — Edhe unë.

FILIPI — Kush e mori?

FREDA — Gjoni.

FILIPI — Ku është ai?

LAJDJA — Nuk duket kund.

TEFA — O Gjon!

FREDA — Gjon, Gjon!

FILIPI — Mos thirrni ashtu si hajvanë. Gjon more! Dil, ku je fshehur, merr vesh, se ndryshe t'i thyej brinjët. Ka ikë! Oh, ç'na gjeti! Ja dhamë bish-tin sëpatës, e, ja tani mbaroj pylli edhe ne me të. Thashë unë se ai do të na bëjë ndonjë të zezë, po

ti Lajde: «Merre, merre, se është mëkat ta lësh në gojë të ujkut». Ja tashti, pija lëngun mëshirës sate. Hë, ku të mbytemi pa pare, më thuaj ti zonja Lajde?

LAJDE — Ç'faj kam unë se ke pjellë ujqër ti.

FREDA — Mbaje gojën zonja Lajde.

TEFA — Atë mund ta shash, por kur të na zesh ne me gojë ndale fjalën e keqe në dhëmbë, se ndryshe i hapim edhe ne defterët...

LAJDE — Të gjithëve një gëershërë ju ka prerë.

FREDA — Ti je mall i mirë fort.

LAJDJA — Jam flori unë.

FREDA — Moj bakër edhe e ke shumë.

TEFA — Teneqe fare...

FILIPI — Leni fjalët! O barkaxhi!

NJË ZË — Hë?

FILIPI — Dil ta shoh surratin, more ti.

NJË ZË — Kam punë.

FILIPI — More kastravec faroç, mos kemi lënë aty një arkë?

NJË ZË — Edhe hijet i keni marrë me vete.

FILIPI — Po tallesh, ë? Tallu, tallu, se e di që i kam duart e lidhura tani. Eh, eh, eh! (Pauzë e shkurtë.) E pat kjo... pa pare... ku të mbytemi?

NJË ZË — Mos ankonit për atë: dy hapa larg e keni detin.

FILIPI — Pusho! Qen!

NJË ZË — Ti vetë pyete...

FILIPI — Prapë ti? Pusho të them! (Vëren përreth me vëmendje,) E marrtë djalli! Një frikë po ma

akullon zemrën. Ky vend tani nuk po më duket as-pak Itali.

LAJDJA — Ta thashë.

FILIPI — Ej ti, more barkaxhi! Ku të tha Zy-ber agai të na zbrësësh?

NJË ZË — Në Itali.

FILIPI — S'është Italia kjo.

FREDA — S'është, babi, s'është. (*Qan*)

FILIPI — Léri lotët tani, buallicë!

TEFA — Huh, sa për së prapthi po shkojnë pu-nët tonë!

FILIPI — Më lini të mendoj pak.

FREDA — Zonja Lajde, ti po këndon-a?

LAJDJA — Jo, po qaj edhe unë... si ti.

FREDA — E sheh, tatë, më përqesh kjo lopa.

LAJDJA — Dhi.

FILIPI — Uf, një kope me të çmendur jemi. Çudi e madhe. E gjetët kohën të ziheni. Në këtë fatke-qësi ne duhet të jemi të bashkuar si gishtat e dorës, e para: Zonja Lajde dhe ti, Fredë, nuk kemi asnjë lek me vete, — jemi në ditë të zezë, si i thonë fjalës, dhe, e dyta: nuk dihet jemi a nuk jemi në Itali, se po të ishim në Itali, diku do të gjeja ndonjë mik.

FREDA — Mamma mia!

TEFA — Domethënë, ik prej shiut e bjerë në breshër.

FILIPI — Edhe më keq. Dëgjo. Tefë, hyrë në barkë dhe shiko për arkën, se ndofta mund ta ketë fshehur varkaxhiu. Eh, qorr ngadalë, se pa hyp atje, gati u rrëzove. Nuk je tjetër, veç një copë mishi me dy sy. Kështu. Hë, de, luaj! Bëji kontroll të imtë: mos lerë as birë miut pa parë.

LAJDE — E pashë mirë që e mori Gjoni,
Lipi.
FILIPI — Rri ti, mos u përziej. Shko, Tefë!

Porsa afrohet Tefa, motovarka lëviz.

TEFA — Po ikën varka.
FILIPI — Hidhu e ktheje këtu.
TEFA — Të hidhem në det thua?
FILIPI — Në varkë, në varkë.
LAJDJA — Iku... Mbetëm këtu si në shkretë-
tirën e Sharcco... fjalë kot.

TEFA — Nuk na mbetet tjetër, veçse të ecim në
këmbë.

FILIPI — Problemi është ku të shkojmë? Hë?
Ku?

FREDA — Të pyesim ata kalimtarët.

Duken ca hije në sfond.

FILIPI — Ej, ju!.. Ikën.
FREDA — Duhet t'ia marrim këngës që t'ju tër-
heqim vëmendjen. Si thua, babi?

FILIPI — Bëni ç'doni, mua nuk më punon më
kjo që kam mbi qafë.

FREDA — (*Këndon*)

Kuando Spunta la luna marekiare,
Tutti i pesiolini fan' l'amore...

FILIPI — Ssst! Mbylle të shkretën, mbylle,

TEFA — Diku po këndoja.

FREDA — I bëra vetë të këndoja,

LAJDJA — Këngë lapçë!

FREDA — Lebrit në Itali!

TEFA — Gjithshka është e mundur.

LAJDJA — Po të jemi në Itali, këta janë arbreshë, se edhe ata kështu këndojojnë.

FILIPI — Dy fjalë ka këtu, ose jemi në Shqipëri, ose shqiptarët paskan zaptuar edhe Italinë e këndojojnë.

TEFA — Mua nuk më duket çudi të jetë edhe njëra edhe tjetra.

FREDA — Jo, jo, në Shqipëri nuk jemi. Nuk duhet të jemi. Bëmë gjithatë udhëtim me barkë, e pse? Për t'u kthyer aty nga u nisëm. Mos na çmendni edhe ju me këto marrëzira. (*Qan*)

LAJDJA — Prapë po bie shi...

FREDA — Hëh, femër pa krypë, ja ç'je ti.

LAJDJA — Jam e sheqerosur unë, vërtet. Po, të kisha krypë, do nxirrja edhe unë shëllirë nga sytë.

FREDA — Dëgjon babi si më fyeni kjo balena këtu?

FILIPI — Edhe ju, na plasët! Vapori po mbytet, e ju thoni: Hëde, pse nuk dalim në breg! Rrini, mjaft! (*Pasi mendon.*) Jam më se i bindur se këtu jemi në Jugosllavi.

FREDA — Mbaruam... Me se të merremi vesh me ata, me gishta?

LAJDJA — Përsëri nuk ke qëlluar në shenjë, Lipi. Po lebrit, ç'duan këtu? Mos e pushtuan edhe Jugosllavinë.

TEFA — E, e, këtë desha të them edhe unë.

FILIPI — Zonja Lajde, më vjen keq, po është më mirë të ta them. Je mendjedadhe.

LAJDJA — Ç'hyn (*qesh*) Oh, po ç'hyn kjo këtu?

FILIPI — Hyn, hyn, e ke për të parë se hyn. Asnjë nga këta kokat e Bunëve, nuk ta mbush syrin ty. Mos harro se futa edhe timen, ë? Të duken bosh ty këto, hë? (*E prek kokën*)

LAJDJA — (s.s.) U prek edhe ky. Mirë, rrini më shëndet se unë po shkoj në punë time. (*Niset*)

FILIPI — Prit! Të ndaloj të ikësh. Jo, ti duhet të rrish këtu, pranë meje. (*I del para*) Unë kam nevojë për ty Lajde, shpirt. Mos ma kthe shpinën tani. Mos!

LAJDJA — S'guxon të flasi njeriu një fjalë, hidheni e t'i nxjerrni sytë.

FILIPI — Fol, shpirt, thuaj ç'të duash, veç mos më braktis.

LAJDJA — Tani as që më kujtohet ç'thashë.

FILIPI — Pse, i harroj unë fjalët tuaja. I kam këtu të ruajtura. Ti the, si mund të jenë lebrit atje... ose këtu, ta zemë, në Jugosllavi. Duket se ty t'u duk budallallék ajo që thashë unë. Po, ke të drejtë shpirt, ke shumë të drejtë të mendosh ashtu, pa shpjegimin që do të jap tani. Më parë duhet ta dish... jo, ta dini, se nuk grij fjalë kot si çarku i duhanit, jo. Thashë jemi në Jugosllavi edhe pse këndojnë lebrit, sepse, zonja Lajde, kam marrë informatë të sigurtë, që janë nisë pesë brigada partizane shqiptare, për të ciluar Jugosllavinë.

TEFA — Në vend ta çlironjë, mund edhe ta zaptojnë. Dhe nuk bëjnë keq.

LAJDJA — Uh! Më mërzitet. Tërë këto llafe për hiçgjë.

FREDA — Dikush po vjen.

LAJDJA — Ne nuk jemi askund, këtë e di,

FILIPI — Ssst!

LAJDJA — Mos m'u gërmush, ti, ej, se nuk më ke as robinë as grua!

FILIPI — Pusho shpirt, nuk sheh, se më në fund shpëtuam. — Ja, po vinë. Vemte, vemte sinjori. Ose, në qofshin jugosllavë, Zdravo!

TEFA — Zdravo!

FREDA — Zdravo!

Një partizan del në dritë.

FILIPI — Oh!

LAJDJA — Partizan.

TEFA — Derisa nuk ka folë, nuk mund t'i vëmë edhe kombësinë.

FILIPI — Shqiptar një copë, more hajvan, plasi sytë. Kjo domethanë, se jemi të tradhëtuar nga barkaxhiu.

LAJDJA — (*Filipit*) Afrohu e foli me të butë. Hëde, ç'rri si gur varri.

FILIPI — Më duket sikur po më han me atë shikim të egër, ai atje, prandaj...

LAJDJA — A kërkon kënd, more shok-a?

PARTIZANI — (*Filipit*) Ti je, major Filip Babuna?

FILIPI — Siurdhëron, unë.

FREDA — Çudi, e njohka tatën!

FILIPI — Më njihni, zoti Partizan?

PARTIZANI — Oh, si jo, ti na ke shumë borxhe...

FREDA — Borxhe mund t'ju ketë, zoti partizan, po nuk ka asnjë lek në xhep i shkreti.

TEFA — Sepse, që ta dish, arkën ku kishim ato... e mori ai, Gjoni, vllai im.

FILIFI — Eh, vërtet, zoti partizan, më ndihmo-ni ta gjej atë kusar.

PARTIZANI — Mos u shqetësoni: ai ju pret atje në komandë.

TEFA — E zutë?

PARTIZANI — Po. Tani erdhëm t'ju marrim edhe ju.

FREDA — Falemnderit për kujdesin, zoti partizan, po na thoni: Ku jemi?

PARTIZANI — Në Shqipëri, ku tjetër.

FREDA, LAJDJA, TEFA — në një gojë: (*me habi e me tmerr*) Në Shqipëri.

Perdja

